


Normalisti

-NORMALISTI- — BOTIM I SHKOLLËS PEDAGOGJIKE T'ELBASANIT
(Me rastin e 50-vjetorit të shkollës 1909-1959)



Ndërtesa e re dhe moderne e Shkollës Pedagogjike të Elbasanit.

Muzeu i Shkollës Normale

L E N D A :

	Faqe
Prof. ALEKSANDËR XHUVANI	— Përvjetor i lavdishëm 3
	— Shkolla Normale e Elbasanit u hap dhe u mbajt me luftën dhe përpjekjet e popullit 5
KAHREMAN YLLI	— Normalja dhe normalistët në 50-vjetorin e tyre 8
MAHIR DOMI	— Shkolla Normale e Elbasanit për lavrimin e gjuhës Shqipe 10
KËTU E 50 VJET MË PËRË	
	— Fillkrenimi i Mësojtores Normale 12
	— Përpërimi në Shkollën Normale 17
	— Nxënësit e shkollës Normale 19
	— Provimet e botëshme të Shkollës Normale shqipe n' Elbasan 21
KUJTIME...	
GAMIL ÇELA	— 50-vjetori i Shkollës Normale (1909-1959) 23
ABEDIN ÇAUSHI	— Një fletë nga ditari i kujtimeve 27
SAMI BAHOLLI	— Disa kujtime nga Shkolla Normale 29
SIRI SHAPLLO	— Normalistët — pëstarë aktivë në revolucionin demokratiko-borgjez të vitit 1924 32
RRUGA E SHKOLLËS NORMALE	
V-SIL KAMAMI	— Shkolla jonë pedagogjike ecën përpara, drejt suksesesh të reja! 37
S. PAPANISTO, A KAJANAKU	— Puna që ka bërë Normalja e Elbasanit për ndjekjen e zhvillimit të metodave mësimore 47
MUSA Tafa	— Puna e ushtrimit të sonë për përgatitjen e më- suësve të rinj 51
	— Lista e dëshmorëve të Shkollës Normale 55

PËRVJETOR I LAVDISHËM

Më 1 dhjetor të këtij viti kremtohet 50-vjetori i themelimit të Shkollës Normale t'Elbasanit. Ky nuk është një përvjetor i thjeshtë i një shkollë të mesme, por një ngjarje e rëndësishme për popullin tonë, pse historia e së parës Shkollë Normale gërshetohet me historinë tonë kombëtare.

E drejta për arësim dhe kulturë nuk u dha me mirëdashje nga Turqia, por u fitua me luftë, gjak dhe sakrifica.

Hapja e së parës shkollë të mesme për përgatitjen e mësuesve që si një rreze drite në errësirën shekullore, që mbulonte vëndin tonë, rreze kjo që do të përhapesh në të katër anët e Shqipërisë për të ndritur sytë e popullit dhe për të verbuar armiqtë.

Se sa me hare e pritën këtë shkollë patriotët dhe se ç'shpresa kishin tek ajo, këtë na e shpreh bukur patrioti i çuar, drejtori i parë i «Normales», Luigj Gurakuqi, në fjalimin e mbajtur ditën e hapjes së shkollës: «Dita e sotshme, kjo ditë e bardhë e plot hare, që gëdhini sot mbi qytetin tonë, do të mbetet si një ditë e madhe, si një ditë e shquame e e paharrueshme në histori të kombit tonë; do të qëndrojë si një kremte e shenjtë e e përvjetëshme, e cila do të lutet me nderim e me brohorië, babë mbas babe e djalë mbas djali, ndër kohnat e pamëruarshme që do të vijnë e gjer në jetë të jetës».

Me të marrë vesh këtë sihariq të madh, nga të katër anët e Atdheut filluan të vijnë nxënës e profesorë dhe puna filloi së mbari.

E mbështetur në mbarë popullin, «Normalja» qëndroi e fortë dhe as ndjekjet e Shefqet Durgut Pashës, as ndërhyrjet e pjesëmarrësve në luftën ballkanike, as ngatërresat e austro-hungarezëve nuk mundën ta ndalonin punën e saj.

Ndonëse ka punuar në një kohë kur ishte në fuqi klasa feudalo-borgjeze, që e përdorte arësimin dhe kulturën si armë në duart e saj, prapë se prapë «Normalja» ka bërë një punë shumë të mirë në dobi të Atdheut. Nxënësit e saj, që në pjesën dërmuese ishin nga shtresat e varfëra dhe të mesme të qytetit dhe të fshatit, kanë bërë një punë shumë të madhe për të përhapur dritën e arësimit edhe në skajet më të largëta t'Atdheut; ata u lidhën me popullin, njohën hallet dhe vuajtjet e tij. Prandaj edhe populli i deshi dhe i nderoi, dhe emërin e Shkollës Normale e kishte si diçka të shtrenjtë, sepse andej vinte drita dhe dituria. Veçanërisht Shkolla Normale i hyri në zemër popullit t'Elbasanit, që e quajti me emërin «Shkolla jonë»; kur klika sunduese deshë ta shpërngulte nga Elbasani për në Shkodër, populli u ngrit në këmbë dhe e ndaloi.

Edukata patriotike, që iu dha nxënësve të shkollës nga mësuesit e atëherëshëm, shprehet bukur në fjalët që Luigj Gurakuqi shqiptoi në ceremoninë e themelimit të shkollës: Elbasani, sikundër është mezi i Shqypniës landore, ashtu do të jetë edhe mezi i Shqypniës mendore: do të jetë truni, do të jetë zembëra e të gjithë Shqyptarëve. Këtu katundësi me qytetarin, malësori me fusharakun do të bashkëtrajtojnë e do të bahen një. Këtu Toska me Gegën do të derdhen, do të nreten, do të përzihen bashkë, do të përnjëshmohen e do të harrojnë emnat e tyre; këtu gjuha shqype, tue u-përkulun pas kësaj ligjitate t'ambël do të marrë një trajtë e një fytyrë të përbashkmë; këndeje do të dalin Shqipëtarë, vetëm Shqypëtarë».

Kjo punë, që u vazhdua nga mësues të tjerë, si Aleksandër Xhuvani, Petër Dodbibë, Simon Shuteriqi, Kostaq Cipua, etj., dha frutin e saj veçanërisht gjatë luftës nacional-çlirimtare, kur qindra nxënës lanë bankat dhe rrokën armët për t'i dalë zot Atdheut. Shumë prej tyre i bënë fli popullit jetën në lulen e rinisë dhe sot shkolla jonë krenohet me kurorën e lavdishme që i thurën të 45 dëshmorët e dalë nga gjiri i saj.

Pas çlirimit t'Atdheut, edhe për Shkollën «Normale» filloi një jetë e re. Ajo tani u bë plotësisht shkollë e masave. Programet dhe tekstet u ndryshuan, duke u vendosur në bazat e shëndosha të marksizëm-leninizmit; u forcua karakteri profesional i shkollës.

Shkolla jonë i drejton sytë nga eksperiencia e ndritur e shkollës sovjetike dhe mundohet ta thithë si bleta nektarin e lules.

Por në rast se sot, të lirë dhe plot hare, përgatitemi të krenojmë 50-vjetorin e themelimit të shkollës sonë, kjo i dedikohet udhëheqjes së ndritur të Partisë, që me dorë të sigurtë i prin anijes sonë drejt limanit të lumturisë, drejt socializmit.

Na kemi fatin ta krenojmë këtë përvjetor në kuadrin e festës së madhe të 15-vjetorit të çlirimit.

Suksese të mahnitëshme janë arritur gjatë kësaj periudhe: atje, ku më parë shtrihej kënetë, sot ngrihet madhështor kombinati i sheqerit; atje, ku kishte ferra dhe gjemba, punon me vrull kombinati i tekstilit ose i naftës; atje, ku toka ishte e shkretëtirë dhe njerëz e kafshë zburiteshin për një pikë ujë, sot lëvrijnë kanale me ujë të kulluar; atje, ku ish skamja, mjerimi, varfëria, sot buçet gazi dhe hareja. Analfabetizmi u zhduk, janë hapur shkolla edhe në skajet më të largëta t'Atdheut. Në kryeqytetin tonë të bukur ngrihet madhështor Universiteti. Prapambetja dhe padituria po struken thellë dhe më thellë, po zhduken krejt nga projektori i ditorisë dhe i kulturës, që drejtohet nga Partia jonë e Punës.

«Normalja» ze një vend nderi në luftën e madhe që po bën populli ynë për arësimin. Nga të 2130 kuadrot që kanë dalë nga gjiri i saj, shumica dërmonjëse punojnë me të gjitha forcat për jetën e re: nga gjiri i tyre kanë dalë 4 «Mësonjës të Popullit», 8 «Mësonjës të Merituar», disa qindra mësonjës janë dekoruar për punë të mirë në arësim.

Në këtë ditë gëzimi nxënësit e vjetër dhe të rinj i premtojnë Partisë dhe Qeverisë, i premtojnë popullit, se kudo që të jenë do t'i venë të gjitha forcat për t'i shërbyer sa më mirë Atdheut dhe për ta mbajtur kart emërin e shkollës së tyre të vjetër, «Normales».

REDAKSIA

Shkolla Normale e Elbasanit u hap dhe u mbajt me luftën dhe përpjekjet e popullit

Shkolla Normale e Elbasanit u çel kur u shpall në Turqi më 1908 kushtetuta, e cila u njipte të drejtën shqiptarëve për të çelë shkolla kombëtare në gjuhë shqipe, këndimi dhe shkrimi i së cilës ishte ndaluar deri atëhere prej qeverisë turke. Mbas shpalljes së kësaj kushtetute u çelën klube nëpër gjithë qytetet e Shqipnisë, u hapën shkolla fillore në gjuhë shqipe dhe u themelue në Korçë Shoqënia **Përparimi** për të përhapë kulturën në Shqipni me anë të gjuhës shqipe. U mblodh edhe një Kongres atëhere në Elbasan prej përfaqësuesve të klubeve dhe intelektualëve të vendit. Ky Kongres, veç të tjerave vendosi, që të çilej në Elbasan një Shkollë Normale, ku do të baheshin gati mësues për shkolla fillore. Me gjithë se u-dha liria për të çelë shkolla shqipe, qeveria turke nuk mirrte përsipër, që t'i mbante këto shkolla me buxhetin e vet. Gjithë këto shkolla shqipe do të mbaheshin prej shqipëtarëve vetë. Prandaj për themelimin e Shkollës Normale u ba një fushatë ndihmash nga gjith'anët e Shqipnisë, dhe shumat e mbledhuna i dërgoheshin në Korçë shoqënisë **Përparimi**, e cila u themelue, si u tha, me qëllim «**që të hapi e të përmbajë msojtore shqiptare**», sikurse thoshte neni i parë i rregullores së asaj shoqënie.

Kongresi i Elbasanit vendosi që Shkolla Normale të hapej në vjeshtë të parë të vitit 1909, po, për shkak se nuk qe e mundur që të baheshin gati me kohë punët e nevojëshme, shkolla u-çel më vonë, në dhjetor të atij viti. U-mblodhën nxanës nga gjithë viset e Shqipnisë, që kishin ndjekë shkolla fillore ose të mesme të ndryshme, në gjuhë turqishte e greqishte. Me qenë se, si u tha, gjuha shqipe ishte e ndalueme, nuk dishin shqip me këndue me shkruie **gjithë** nxanësit: se me gjithë ndalimin e gjuhës, shumëkush nga njerëzia e nga rinia e mësojshin fshehtas shqipën me anë të librave të Naimit e të Samiut, që futeshin fshehurazi në Shqipni e shpërndaheshin nëpër popull. E kështu atyne nxanësve që nuk dishin këndim e shkrim shqip u bahej një kurs gjuhe për një kohë të shkurtën, sa për ta shkruie e ta këndue gjuhën. Nga Kosova na erdhën atëhere, të dërguem prej Hasan Prishtinës, nja 50 e sa vetë, e kështu u-mblodhën përbmi 100 e sa nxanës nga Elbasani e nga viset e tjera të Shqipnisë. U-danë mbas studimevet të tyne në tri klasë. Programi e mësimevet ishte ajo e një qytetsje tri klasësh dhe mbas mbarimit të klasës së tretë do të fillonte Normalja e vërtetë. Nxanësit, veç elbasanasvet, ishin të gjithë bursistë dhe mbaheshin në një internat, që ishte një ndërtesë e veçantë prej shkollës. Shkolla varej nga shoqënia «**Përpa-**

rimi» e Korçës, e cila me t'ardhunat e saj prej ndihmavet të shqiptarëvet mbante gjithë ç'i duheshin shkollës për mbarëvajtjen e saj. Veç kësaj, n'Elbasan kishte një këshill prej parësisë së vendit, që në marrëveshje me shoqërinë «Përparimi» kishte administrimin e gjithë shkollës.

Profesorë të rregullshëm të shkollës u zgjodhën qysh prej Kongresit t'Elbasanit Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Aleksandër Xhuvani, Petër Dod-biba, etj. Si Drejtor u-zgjodh prej këshillit administrativ të vendit Luigj Gurakuqi. Veç këtyreve mirrshin pjesë në mësimet e shkollës edhe Hasan Mezja, Hajdar Blloshmi për gjuhën frengjishte, Dhimitër Paparistja për gjimnastikë dhe Simon Shuteriqi për t'u mësuar fillimet e gjuhës atyne pak nrxanësvet, që nuk dishin këndimin e shkrimin e shqipes.

Ishte e para herë në gjithë landët e mësimet po baheshin në gjuhë shqipe, dhe e mbaj mend se kemi heqë munxë të madhe tue i hartue e tue i shkruet gjithë landët e mësimet shqip e tue ua spjegue nrxanës-vet. Sa ndryshim i madh asht me kohën e sotme, kur me zhvillimin e madh që ka marrë gjuha, arësintarët nuk e ndiejnë ma, në të shprehun e në të mësuem shqip, atë vështirsi, që kemi pasë ne atëhere! Mbas aso kohë, veç atyne vepravet të paka të botueme në Bukuresht e në Sofje me kulturë të përgjithëshme, prej Rilindasve tonë, mungojshin tekste shkollore në gjuhë shqipe, mësimet, si ua shpjegojshim nrxanësve, ua jipshim me të shkrueme, në dispensa: i shkruetjshim pra mësimet së pari me dorë, mbandaj letrën e shkrueme e shtrijshim përmbi një dërrasë pak të fellë katërkandshe, të ndërtueme për këtë qëllim, së cilës i shtihej mbrenda një farë lande e bardhë si pelte, që vinte së jashtmi e shtime në kutia teneqeje dy kilëshe. Shkrihej kjo landë në zjarr dhe shtihej n'ato dërrasa, ku ngrinte mbas një cope here; prej shkrimit që ngulej aty nga letra e shkrueme nxirreshin nga 50 e 60 kopje për çdo mësim, që dilshin këthjellët e lexoheshin mirë, e kështu ua shpërndajshim nrxanësve. Këso dërrasash kishim shumë nga një për çdo mësim. Me këtë mënyrë primitive e kemi mbarue punën e gjithë landëvet të mësimi.

Populli i Elbasanit, si edhe i gjithë Shqipnisë, kujdesoheshin me të madhe për Shkollën Normale dhe e ndiqshin me interesim të madh gjithë punën e saj, se kjo ishte e para shkollë shqipe e mesme që hapej në Shqipni mbas kaqë shekujsh. Në mes të një entuziasmi të madh u banë provimet e Normales në fund të vitit, me një ligjëratë panegjirike të bukur të mbajtur prej Drejtorit Luigj Gurakuqit.

Por Shkolla Normale nuk u hap vitin e ardhshëm shkollor, se qeveria turke, e zanë frike prej kryengritjes në Kosovë e prej lëvizjes nacionaliste, që u-përhap në gjithë Shqipninë, dërgoi një ushtri të madhe ndën Turgut Pashës, për të shtypë kryengritjen dhe lëvizjen kombëtare. Me shumicë shqiptarësh u zunë, u burgosën e u torturuen asaj kohe prej asaj ushtrie barbare, dhe shumë të tjerë, për të shpëtue nga gjithë këto, duelen jashtë atdheut, sikurse i ndëshkruemi. Por valën e lëvizjes kombëtare nuk e shugati dot ajo fushatë e Turqisë, e cila u-shtrëngue mbandaj të japë lejë, që të hapej prapë Normalja në mes të vitit 1911-1912, por me personel tjetër. Porse u-mbyll pa u-mbarue viti shkollor për shkak të luftës ballkanike, kur u-shkel Shqipnia e mesme prej ushtrisë serbe. Do shtue kështu se qeveria imperialiste e Beogradit, kurdoherë anmike mbandaj e kombit shqiptar, kishte në planin e saj, që të hapë në Shqipni shkolla në gjuhë serbe, e për këtë qëllim solli n'Elbasan shumë libra shkollore serbisht. Por nuk ja duel dot këtij qëllimi djallëzor se u-shtrëngue politikisht, që ta kpusë qafën prej Shqipnisë. Këtë politikë imperialiste

çkombëtarizimi ndjek edhe sot qeveria jugosllave e Beogradit kundrejt kosovarëve, tue i mbyllë shkollat shqipe për gjithfarë shkaqesh të paqena e tue punë mazorit të zezash me popullsinë shqiptare të Kosovës.

Kur u-shpall pavarësia e Shqipnisë në Vionë, Normalja i hapi prapë dyert e saj në vitin shkollor 1913-1914, dhe atëhere filluen së pari në mënyrë sistematike landët pedagogjike tue u-mësue psikologjia e didaktika. Por u-mbyll gjatë kryengritjes së Shqipnisë së mesme e në fillim të luftës së parë botnore dhe u hap më 1917, kur ishte Shqipnia e mesme dhe e Veriut ndën pushtimin ushtarak t'Austrisë. Në këtë kohë u-hapën mjaft shkolla fillore nëpër këto vise të Shqipnisë, dhe të gjitha bashkë me Normalen mbaheshin e vareshin administrativisht prej Drejtorisë së Përgjithëshme t'Arësimit, e cila me Luigj Gurakuqin në krye e kishte selinë në Shkodër. Qysh atëhere hyni në Normale sistemi austriak i mësimit.

Mbas Kongresit të Lushnjës e tëhu Normalja e vijoi punën e saj rregullisht, tue u-përmirësue gjithënji me personel të mirë e nëpër një rrugë të mbarë në punë të anës didaktike dhe edukative. Më 1923-1924 u-hap shkolla ushtrimore e Shkollës Normale me personel të zgjedhun dhe mbas sistemit austriak. Qysh prej atij viti e mbrapa dilte nga Normalja për çdo vit një kontigjent prej 25-30 mësuesish, që me metodën e tyne të fitueme nga Normalja i dhanë atëhere një frymë të re arësimit fillor, frymë të re në krahasim me metodën e vjetër të përparëshme.

Mësimet në Shkollën Normale baheshin me një frymë laike e kombëtare. Besimi, ky mësim, i futun nëpër shkolla të tjera, që ka sjellë gjithmonë dasinë në mes elementeve të popullit, nuk zinte vend në landët e mësimet të Normales. Për këtë frymë liberale e krejt patriotike të shkollës, Normalja shumë herë nuk shifej me sy të mirë prej frymës prapanike të qeverivet antipopullore; sidomos ajo ishte halë në sy të klerit katolik, i cili nuk e duronte një institut, që edukonte bijt e popullit me frymë laike jashtë dogmave fetare. Prandaj ierarkia e këtij kleri s'la gur pa luejtë për ta mbyllë shkollën Normale t'Elbasanit e për ta hapë në Shkodër. Por masat që ka dashë të marrë dy herë Ministria e Arsimit më 1924 e më 1935, ndën presionin e ierarkisë s'atij kleri, për ta shpërnguljen Normalen në Shkodër osë për ta paralizue vepimin e saj me shpërnguljen e disa klasëve, këto masa dështuen, pse shkaktuen protestime e lëvizje patriotike të popullsisë s'Elbasanit, që banë mos me u-luejtë Normalja prej Elbasanit.

E kështu Shkolla Normale gjatë një periode prej 30 e sa vjeç, qysh prej shpalljes së pavarësisë në Vlorë deri në çlirimin e Shqipnisë prej ushtrisë nacional-çlirimtare, e mbaroi misionin e vet kulturor e kombëtar. Shkolla Pedagogjike e sotme e Elbasanit, me parimet e reja socialiste t'edukatës dhe me përkrahjen e pakursyme të Partisë e të Qeverisë, ka hymë në një periudë përtërimit e përmirësimit me rranjë dhe po e kryen më mirë mësimin e saj të naltë për të mirën e arësimit popullor dhe të kulturës së vendit.

PROF. ALEKSANDËR XHUVANI

NORMALJA DHE NORMALISTËT NË 50-VJETORIN E TYRE

KAHREMAN YLLI

Zv/Ministër i Arësimit e Kulturës

Në fletët e këtij botimi po kujtohet sot rruga e shkëlqyer nëpër të cilën ka ecur Normalja dhe normalistët e saj. Them rrugë e shkëlqyer, pse nuk ka rrugë më të shkëlqyer se sa ajo që çahet me mend, me sakrifica, e që në ballë të saj qëndron një mision aq i lartë se ai i mësuesit, i përhapjes së dijes dhe të kulturës, i zgjimit të njeriut nga padija.

Të gjitha këto do të jenë përkujtuar mirë e bukur në artikujt e tjerë nga pedagogë e normalistë. Po edhe unë desha të them dy fjalë, pse, si normalist, më pëlqen të shkruaj diçka me këtë rast, sidomos sepse Normalja jonë nuk është vetëm e normalistëve; ajo është Normalja e gjithë Shqipërisë.

Dhe me të vërtetë roli dhe funksioni i Normales është një rol dhe funksion në shkallë nacionale; dhe e tillë ka qenë Normalja që në fillim, që në ditën e themelimit të saj më 1909.

Secili prej nesh besoj se ndjen një kënaqësi të veçantë kur në fjalën e Luigj Gurakuqit me rastin e mbylljes së vitit të parë shkollor më 1910, ndër të tjera lexon edhe këto «...djemt t'onë ardhën nga të gjitha viset e Shqypëniës, e u-derdhën këtu n'Elbasan... sa që mund të thohet pa frikë lajthimi se nuk kaa kant të Shqypëniës që mos të këtë këtu mbrenda përfaqësonjësën e tij».

Jemi më 1910. Shqipëria s'është akoma e pavarur, ajo natyrisht s'ka akoma një qendër të vetme, që të drejtonte punën dhe fatet e saj; por me gjithë këtë, patriotët shqiptarë me hapjen e Normales krijuan një kryeqendër të mësimt e të diturisë mu brënda në Shqipëri, ku erdhën bijt e shqipes nga të gjitha anët edhe nga Kosova, për të marrë mësim e për t'u bërë mësues.

Pak nga pak, por vazhdimisht, Normalja nxirte normalistët e saj, këta misionarë të gjuhës amëtare, për shkrimin dhe leximin e së cilës aq shumë etje dhe aq shumë nevojë kish populli ynë.

Që nga viti 1909 dhe gjer në vitin 1944 rreth 950 mësues i dha vendit Shkolla Normale; mësues me aftësi të plota, me një ndjenjë të lartë detyre, të cilët në shumicën e tyre dërmuese u shërbyen dhe u shërbejnë interesave të shkollës dhe t'Atdheut me zell dhe besnikëri. Normalja mburret me Avni Rustemin, këtë figurë revolucionare dhe patriotike të vendit tonë, ashtu siç mburret me Ndrec Ndue Gjokën dhe Qamil Guranjakun, këta arësimitarë të palodhur në themelimin dhe përhapjen e shkollës së re t'arësimit tonë popullor. Normalja me të drejtë mburret me gjakun e 45 dëshmorëve që i dha Atdheut gjatë jetës së saj 50-vjeçare.

Duhet thënë gjithashtu se pas çlirimit t'Atdheut normalistët qenë bërthama kryesore që mbajti peshën më të madhe të punës së shkollës: nga radha e tyre dolën drejtuesit e shkollave, përgjegjësit e rretheve metodike, inspektorë dhe përgjegjës të seksioneve t'arësimit e kulturës. Për aftësitë dhe eksperiencën e tyre, normalistët ishin kuadrot kryesore që i u përgjigjën nevojave të shkollës shtatëvjeçare, duke shërbyer si mësues në të tri klasat e larta të saj. Edhe sot normalistët më të mirë shërbejnë në këto shkolla.

Për merita në punë mbi 200 normalistë mbajnë urdhëra dhe medalje të ndryshme t'akorduara nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Vetë Shkolla Normale, sot Shkolla Pedagogjike «10 Korrik» e Elbasanit, për shërbimet që i ka bërë çështjes s'arësimit dhe Atdheut është e dekoruar me Urdhërin e Punës të Klasës së Parë. Gjat 50 vjetëve ajo ka përgatitur më tepër se 2.080 mësues ose 950 mësues që nga themelimi i saj e gjer më 1944 dhe 1.130 mësues që nga viti 1944 e gjer më sot. Asnjë shkollë në Shqipëri nuk ka nxjerrë një numur të tillë kuadroshe, asnjë shkollë në Shqipëri nuk i ka shërbyer kaq mirë çështjes s'arësimit.

Prandaj me të drejtë sot ne mburemi që kemi një shkollë të tillë dhe u urojmë nxënësve e pedagogëve të ta mbajnë me nder emërin e Normales dhe të ruajnë e të zhvillojnë me ngulm traditat e punës së saj, pse edhe detyrat që ata kanë përpara janë të mëdha.

Ne nuk kemi sot jo më një «normale»; ne kemi tani 9 «normale» ose shkolla pedagogjike, që përgatitin mësues e megjithatë nevojat për mësues janë akoma të ndijëshme, pse zgjerimi i arësimit tek ne ecën me ritëm të shpejtë. Harta e Shqipërisë së Re është mbuluar tani me plot shkolla e ndër to punojnë sivjet mbi 10.000 arësimitarë, shumica dërmuese e të cilëve janë përgatitur në shkollat pedagogjike të mesme e të larta të vendit. Afër 4.000 nxënës e studentë janë duke u përgatitur sot në këto shkolla e ky numur do të rritet akoma më shumë.

Pushteti popullor i hapi rrugën dijes dhe kulturës. Ai i hapi rrugën edhe arësimit pedagogjik të mesëm e të lartë. Veç 9 shkollave pedagogjike, ne kemi tani edhe 2 institute pedagogjike për mësuesit, veç fakulteteve t'Universitetit Shtetëror të Tiranës.

Në të gjithë këtë sistem shkollash përgatiten edukatorët e brezit të ri të Shqipërisë sonë të lirë.

Të gjithë këto nderojnë e përshëndetin sot me respekt punën 50-vjeçare të Normales dhe të normalistëve, dhe urojmë nga zemra që në t'ardhmen e ndritur t'arësimit tonë popullor të shkëlqejë gjithmonë emri i Normales s'Elbasanit.

Shkolla Normale e Elbasanit për lavrimin e gjuhës shqipe

Shkolla Normale e Elbasanit që e para shkollë e mesme kombëtare shqipe. Ajo hapi dyert në një periudhë ngritjeje të Rilindjes sonë, dhe që një nga aksionet më të rëndësishme të lëvizjes kulture-patriotike të kësaj faze. Dihet rëndësia e madhe që i epnin rilindasit gjuhës, lavrimin të saj, arësimin në gjuhë amtare, si dhe puna e madhe që bënë ata për përpunimin e zhvillimin e shqipes si gjuhë letrare. Shkolla Normale do të përgatiste kuadrot që, të shpërndarë në të katër anët e Shqipërisë, do të arësonin fëmijët në gjuhën e nënës, do të përhapnin kudo idet atdhetare. Ishte e natyrshme që mësimi i gjuhës shqipe të mirrte në këtë shkollë një vend të parë, t'i jipej një rëndësi e veçantë, pse i lidhur me detyra patriotike të shënuara.

Shkolla Normale e Elbasanit pati në anë tjetër fatin të ketë si drejtorë e pedagogë lëvruar të shquar të gjuhës sonë, ose studjues të vemendëshëm e njohës të mirë të saj, puna e veprimtaria e të cilëve pati frut dhe la gjurma. Drejtor i parë i saj që Luigj Gurakuqi, me merita të mëdha në zhvillimin e gjuhës letrare shqipe në përpunimin e gjuhës, së prozës, në njëzimin e stabilizimin e ortografisë. Në muret e saj u zhvillua për rreth 30 vjet me detyrën e drejtorit dhe të pedagogut të gjuhës veprimtaria e lavruesit të njohur të gjuhës shqipe, dekanit të gjuhësisë shqiptare, Prof. Dr. Aleksandër Xhuvanit. Aty për afër një të katërt shekulli dha mësim me dashuri të madhe për fjalën shqipe e me një ndërgjegje të lartë pune një gjurmues i imtë i gjuhës sonë e i dialekteve e të folmeve të saj, si Simon Shuteriqi.

Gjithë këto ndihmuan në krijimin e një tradite pozitive që e bëri të shquhet Shkollën Normale të Elba-

nit dhe t'i sjelli shërbime jo të vogla gjuhës shqipe, mësimin po dhe lavrimin e studimit të saj: 1) me përparimin e lëndës së gramatikës shqipe dhe të teksteve përkatëse; 2) me përpunimin e terminologjive shkencore shkollore; 3) me ngritjen e nivelit të mësimin të gjuhës në shkollat tona nëpërmjet arësimitarëve të përgatitur prej saj; 4) me formimin e një numuri mbledhësish të visarit folkloristik-gjuhësor të popullit tonë dhe me veprimtarinë e zhvilluar prej tyre.

I.— Shkolla Normale, ndër të parat të mesme ku u dha mësim i gramatikës shqipe dhe si një shkollë ku kjo lëndë zuri gjithënjë një vend të parë, që një farkë e mirë për përpunimin e kësaj lënde e për hartimin e teksteve përkatëse. Me shënimet e marra nga bankat e kësaj shkolle nga mësimet e Luigj Gurakuqit, një ish-nxënës i saj i vitit 1909-1910, Ilias Jahja Përmeti hartoi dhe botoi më 1916 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës një gramatikë të gjuhës sonë me material të pasur, ku nuk mungon dhe ndonjë vëzhgim interesantë. Që një frut i mësimave të dhëna në të dy tekstet e para metodike të sintaksës sonë punuar prej A. Xhuvanit (pjesa e parë botuar më 1922 e dyta më 1934) e morën fillim prej tyre dhe dy tekstet e morfologjisë, të hartuara po prej A. Xhuvanit për shkollën fillore (1919-1920). Po këtu u përpunuan shënimet gramatikore të S. Shuteriqit, të përmbledhura më vonë (më 1951) me një studim botuar në Buletinin e Institutit të Shkencave për shkencat shoqërore.

II.— Shkolla Normale u hap në një kohë kur s'kishte tekste të shkollës së mesme për lëndët e ndryshme e kur s'ishte përpunuar veçse në një pjesë të vogël terminologjia shkencore. Asaj i duhej të zhvillonte një punë të gjërë për këto. Ajo u bë një laborator

i mirë për shqipërimin e terminologjive. Në sajë të entuziazmit patriotik, që frymëzonte personelin mësimor të saj, që në vitin e parë të krijimit u hartuan tekste për lëndët e ndryshme, që u shumëzuan në formë dispencash. Hartimi i tyre kërkoi përpunimin e terminologjive përkatëse dhe u krye një punë e gjerë. Ky problem u zgjidh në frymën e Rilindjes, në shembullin e Kristoforidhit, Naimit, Samiut, me një kujdesje të madhe për pastërtinë e gjuhës sonë, duke u krijuar fjalë të reja me brumin e shqipes. Në këto tekste të shputillografuara gjejmë mjaft lëndë për historinë e terminologjisë shqipe, në disa raste dhe tema që e ruajnë dhe sot interesin, ndonjë edhe që mund të nxirret nga harresa për t'u vënë rishtas në përdorim në vend të ndonjë fjale të huaj. Po në këto vite për këtë shkollë u hartuan dhe tekstet e arithmetikës e të gjeometrisë prej Kristo Dakos, në të cilat bëhej një përpjekje e parë e gjerë për shqipërimin e përpunimin e terminologjisë së këtyre lëndëve.

Terminologjia shkollore e sotme e gramatikës është përpunuar nga A. Xhuvani gjatë veprimtarisë mësimore në këtë shkollë, duke u marrë fjalë të Samiut, në ndonjë rast të Kristoforidhit ose duke u formuar fjalë të reja. Po në mësimet e kësaj shkolle u punua nga A. Xhuvani terminologjia e lëndëve të pedagogjisë e psikologjisë, e pasqyruar në formën e saj definitive në veprat e tia «*Fillime të Pedagogjisë. Didaktikë e Edukatë*» (1927-1937) dhe «*Psikologjia*» (1933) si dhe një pjesë e termave letrare (Shih A. Xhuvani — K. Cipo «*Fillime të stilistikës e të letërsisë së përgjithshme*» (1931).

III.— Në sajë të punës sistematike të zhvilluar nga profesorë, si ata që u përmendën më sipër e të tjerë, të dashurisë për gjuhën shqipe që ngjallën ata ndër nxënësit e tyre, normalistët morën një përgatitje të mirë për punën në gjuhën shqipe dhe dalloheshin nga interesi që tregonin për të një pjesë e madhe e tyre dhe nga kujdesi që ki-

shin për ruajtjen e pastërtisë së saj. Ky formim dhe ky qëndrim sollën një rritje të nivelit të mësimit të gjuhës në shkollat fillore plotore, ku mësonin maturanët e Normales s'Elbasanit.

Me mësuesit e dalë prej bankave të saj, që vinin nga gjithë krahinat e Shqipërisë dhe përhapshin në gjithë vendet e saj, Shkolla Normale që edhe një faktor njezues në procesin e zhvillimit të gjuhës së shkruar, që ndihmoi mjaft për kapërximin e dialektizimeve lokale, për përhapjen e stabilizimin e disa normave të përgjithëshme.

IV. Traditat që u krijuan, puna e zhvilluar prej profesorëve të gjuhës, e këtu në radhë të parë duhet përmendur ajo e A. Xhuvanit, arritën të ngjallin në mjaft normalistë entuziazmin për gjuhën amtare dhe interesin për të mbledhur visarin folkloristik-leksikor të popullit tonë. Disa prej tyre u dalluan për veprimtarinë e dendur e punën e pastër që bënë e përfundimet që patën. Mjaft materiale, botoi revista e Normales «*Shkolla Shqiptare*». Ndër arësimitarët që iu përgjigjen thirrjes së Ministrisë së Arësimit për mbledhjen e folklorit e të visarit leksikor të gjuhës sonë dhe i dërguan asaj materiale të shumta, pjesa më e madhe ishin normalistë. Me një pjesë të tyre u botua vëllimi «*Folklor*» I, vëllimet IV, XIII, e XIV të Visareve të Kombit në pjesë më të madhe të tyre. Nga Normalja duallën mbledhës e hulumtues të ndërgjegjshëm, të saktë e seriozë si Jani Llazari, Petër Elezi, Dhosi Liperi, Qemal Haxhihasani e të tjerë, që kanë grumbulluar e pjesërisht botuar materiale të pasura e me vlerë për folklorin e leksikografinë shqipe.

Shkollës pedagogjike të Elbasanit i bie t'i shpjegë më tej këto tradita dhe sot, që kemi institucione shkencore për drejtim e udhëzim i janë krijuar kushte të përshtatëshme pune, të zhvillojë një punë të gjerë e sistematike për mbledhjen e folklorit, etnografisë dhe të materialeve gjuhësore.

M. DOMI

KËTU E 50 VJET MË PARË

Mbi inaugurimin e shkollës Normale t'Elbasanit

(1-XII-1909)

Fillkzëmtimi i Mësojtores Normale

«E tetëmbëdhjeta ditë e Vjeshtës së tretë asht një ditë e madhe e shënueshme për Elbasanasit, ene kujtimi i saj kurdoherë i lulëzueshëm e madhështor ka me mbetun në shpirtinat t'ona me qenë që ndë këtë ditë u kremtue fillkzëmtimi i Mësojtores Normale prej të cilës Shqipnia e tanë sot po pret dritë e ditunië me themel, arësim e një shtollizje mendore të shëndoshë, e cila prej kaqi kohe mjerisht i mungon...».

(Gazeta «Dielli» — Nr. 40, dt. 31 Dhjetor 1909)

Fjala e Z. Gurakuqi

«Dita e sotshme, kjo ditë e bardhë e plot hare, që gëdhini sot mbi qytetin tonë, do të mbetet si një ditë e madhe si një ditë e shquame e e paharrueshme në histori të kombit tonë; do të qëndrojë si një kremte e shënjtë e e përjetëshme, e cila do të lutet me nderim e me brohoritë, babë mbas babe e djalë mbas djali, ndër kohnat e panumëruardhme që do të vijjnë e gjer në jetë të jetës.

Kombi shqypaar, që shkëlqen gjithmonë përmbi t'jerët me trimëniën e fisnikniën e vetë; ky komp që përmendet kudo, e me nderë e me lavdin prej të gjithëve, për besën e burrëniën, që kurr s'i kaa mohuar, ky komp po i shton vetvetes edhe një t'jetrë veti të mirë, dua të them dashuniën për mësimin e për dituniën që e kishite gjithënjë në gjak e në natyrë, po që mjerisht nga shumë e shumë shka-ke nuk mundi gjer më sot t'a rrëfente e t'a zhvillonte ashtu si duhej. Me këtë shkollë të madhe për mësonjës, që ishte dëshiri e shpresa e të parëvet

t'anë prej vjetësh, fillësën e të cilës na jemi mbledhunë sot të kremtojmë bashkërisht, kombi shqypaar po mbiell farën e dituniës, po heth themelin e mësimin, pse nga kjo Shkollë do të dalin ata apostuj të nxehtë e të vullnetshme që do të përhapin dritën ndër ato ma t'errtat vise; do të dalin ato burra njeridashësë, të cilët, si Orfeu e si Amfioni, me urtëriën e me ambëlsiën e fjalëvet e të këshillevet të veta do të zbutin egërsinat, do të tundin currat e shkambinjt, do të qytetërojnë e t'afrojnë njerëzit e t'i bajnë që të duhen e të ndihmohen si vëllau me vëllanë! I math e i parrëfyeshmë asht pra sot gëzimi i jem, o zotërinj të nderëshme, që pata fatin e bardhë të ndodhem ndë mest t'uaj e të marr pjesë ndë hareen e madhe që sot ju ndien zembëra; tepër i lartë asht nderi që më dhuroi i hyjmëshmj Perëndië që të numërohem edhe unë një nga punëtorët e parë që do të përpiqen e do të derdhin djersën e vet për reth kësaj ndërtese të madhe. Po mos kujtoni, o zotërinj të nderëshme, së vetëm zembërat t'ona këndojnë e lulë-

Në 4 materialet që vazhdojnë është respektuar ortografia e origjinaleve

zojnë në ditë të sotshme; moç kujtoni se vetëm shpirti i ynë kënaqet e dëfren. Sot zembërat e Shqypëniës së tanë rrahin për një herë me t'onat, sot shpërtnat e të gjithë Shqypëtarëvet bashkohen me t'anët ndë hare e adë gazmënt!

Ndë malet e larta e të mbuluame me borë, malësorët e rrebtë e të fuqishëm, që me hutën ndë krahanë kurdoherë gati t'i kundërshtohen anmikut e të derdhin gjakun për nder në e Shqypniës; ndër qytetet e mëdhaja tregtarët e kujdesëshmë që përipiqen të shtojnë gjaan e pasuniën e vendit; ndë xhamia e ndë kisha hoxhë e priftën që i falin të lartit Zot shërbimet e veta, të gjithë, po të gjithë e kanë sot të sjellun synin mbi nee, të gjithë janë sot si të varunë prej nesh, e me gaz e me dashunië vërejnë e vështrojnë Elbasanin, këtë qytet të bukur, që polli e ushqu kurdoherë në gjë të vet burra të dijëshëm e të vlefshëm e atdhetarë trimë e të flaktë; vërrejnë e vështrojnë Elbasanin mbi të cilin leu sot një diell i ri që do të përhapë dritën e vetë të shkëlqyeshme e do të lëshojë rrezet e tija jetëpruese mbi të gjithë Shqypniën e ndë tokë të të cilit bini sot një lule e zgjedhune, që do të përndajë erën e vetë ndëpër të tanë qytetet t'ona një erë të hollë e të kandëshme, një erë ditunie e qytetërimi. E jo vetëm Shqypnia e gjallë, o zotnij të nderëshmë, merr sot pjesë ndë gëzim t'onë, po bashkë me të lëkundet e brohoritë edhe Shqypnia e herëshme; edhe ata etnit t'anë që u përkujdesnë aqë fort për gjuhë e për kombësi, edhe ata popo gëzojnë sot e kënaqen për një herit me nee. Mbrenda varrëvet t'errta e të ftohta eshtnat e kocinj' e tyne sot tunden e djersijnë, e një gjamë e lehtë e ndëpër dheë përshton an e kant viset t'ona, zgjon nga gjumi i thellë të vdekunit t'anë e u rrëfen me gëzim ndodhjen e madhe. Anëj nga kodrat e lulëzuame t'Ysqudarit, andej nga sukat e blera e të mveshuna me ullinj e portakalle të Libanit ngrihen

hijet madhështore të Naim be' Fra-shërit e të Vasa Pashës, e, mbi krahet e erës së lehtë, hidhen mbi ranën e xehtë Misirit t'i japin Mehmet Aliut sihariqin e gazmueshmë. Valër e shpejta të Nilit marrin fjalën e tyne, e tue u-bashkuar me tallazet e detit, vijjnë e përipiqen me brigjet e Shqypniës e, për ndën dheë, i sjellin të Madhit Nelko Kristoforidhi përgëzimet e atyne burrave të pavdekunë për ndërtesën e shënjtë, që po themelohet sot në qytet të tij të madhënueshmë... gëzon bashkë me nee edhe njerëzia e tanë, pse mësimi e ditunia, o Zotënij të-nderëshmë, nuk kanë kufij, nuk ka sinore. Arësimi asht i përgjithëshëm, ngulë rranjë kudo, përhapet në çdo vent. Me anë të mësimit e të dituniës njerëzit u-njohnë ma mirë, lidhnë marrëdhënie ndë mest të tyne, u-afëruan, u-bashkuan, u-banë vëllazën. Mësimi e ditunia i rëzuan ato mure të larta që ndanin njeriun prej njeriut; thyen currat e shkambinj, çaan e përshkuan kodrat e malet, lidhnë bashkë fushat e qytetet, sunduan detnat e oqeanet e bashkuan popujt njënin me tjetrin, baan të tanë botë si një fëmijë të madhe e krijuan të gjitha ato çudina që shohim sot e që nuk duken si punët e njeriut.

Kaq mjafton për me rrëfymun vlerën e mësimit, duhet pra t'ua dijmë të mirë e t'u jemi gjithmonë të detyruamun atyne që u munduan me e përhapun ndëpër botë.

Ç'në kohnat e-para njeriu u dha pas dituniës, por u deshën mija vjetësh, që ditunia t'arrinte në shkallën ku ndodhet sot. Ndër Hindianët e vjetër mësimi ishte vetëm fedak; ndër Grekët kishte vetëm për qëllim të mirën e shtetit; ndër Romanët nisë pak nga pak të bëhet njerëzuer. Si ra Mbretënia Romanëvevet erth për mësimin një kohë fare e errtë. Me këtë nuk dua të tham se n'atë kohë nuk ndodheshin njerëz të ditunë, po veç që mësimi nuk ishte i përgjithëshëm kështu që vetëm një pjesë fort,

(Vazhdon në faqen 16)



Luigj Gurakuqi, drejtori i parë i Shkollës Normale t'Elbasanit



Prof. Aleksandër Xhuvani, pedagog dhe drejtor i Shkollës Normale

(Vazhdon nga faqja 13)

e vogël e kombit mund të nxirte fryt e dobië nga ay. Vetëm në vjetën 500 nisëm të shofim disaa shkollë të vogla andej e këtej; po që të gjejmë një njeri që të përpiqet me të vërtetë për të përhapurit e mësimit duhet të zbresim gjer në vjetin 1378 kuur u-lint i emnuemi Vittorino da Feltre, i cili nisi të përkujdeset për mësimin e kombit të tanë. Ma vonë gjurmët e tijja i muarën mbrapa Erasmi prej Roterdanit, Lutheri prej Gjermaniës, Rabelaisi prej Francet, Claudio d'Acquaviva prej Italiës Comenius prej Maraviës, Locke nga Vrigton-i, Basedov nga Hamburgu, filozofi i math Kant, Pestalozzi, Girard-i nga Friburg-u, i cili vuni për parim e themel të Shkollës që mësimi të jipet në gjuhë të nanës, Frederik Froebel-i e shumë tjerë; e ndë kohët e tanishme: Aleksandër Bain-i, Andrea Anguilli e Herbert Spencer-i, një ndër ma të mëdhenjt fillosofë të botës, i cili vdiq në vjetët 1903. Që të thomi të vërtetën, na nuk kemi pasun pedhagjanë, e ditunia kaa mbetunë shumë mbrapa ndë vendet t'ona; me gjithë këtë asht mirë mos të harrohen disa njerëz që u munduan me përhapun mësimin ndër ne, si i shin: Todri, Kristoforidhi, Naim Beu, Vasa Pasha e tjerë.

Thaam se Girard-i qe ndër ma të parët që vuni për themel të mësimit të parë gjuhën e nanës, pse atëhere të gjitha vijnë të lehta, sikundër na tregon pedhagogjia e sotshme e fitimet e çuditëshme që po nxjerrin ata që i bijnë mbrapa këtij parimi. Andaj pra i qoftë lavd e nderë Elbasanit që me Atdhesië e me përparim të vet u-vu ndë krye të qyteteve tjera e po hapë sot këtë shkollë për mësonjës, nga e cila do të përhapet drita e mësimit ndë të gjithë vendin t'onë.

Elbasani, sikundër asht mezi i Shqypniës landore, ashtu do të jetë edhe mezi i Shqypniës mëndore: do të jetë truni, do të jetë zembëra e të gjithë Shqyptarëvet. Këtu katundësi me qytetarin, malësori me fusharakun do të bashkëtrajtojnë e do të bahen një. Këtu Toska me Gogën do të derdhen, do të nntreten, do të përzihen bashkë, do të përnjëshmohen e do të harrojnë emrat e tyne; këtu gjuha shqype, tue u-përkulun pas kësaj ligjirate t'ambele, do të marrë një trajtë e një fytyrë të përbashkmë; këndej do të dalin Shqypëtarë, vetëm Shqypëtarë!».

(Gazeta «Dielli» Nr. 40,41,42.
1909-1910)

PËRPARIMI NË SHKOLLËN NORMALE

Shkolla Normale për gas të-math të-gjithë kombit Shqipëtar dita me ditën po përparon. Për tre muej e gjysmë po thua janë mëshjtjellunë nga katër anët e atdheut më tepër se 100 nxënës, të cilët me mall të vërtetë dhe me një dëshirë të shejtënuëshme janë tue zhvilluemun mendjen e tyne e tue zburkuruemun shpirt dhe zemrë me një arësim të vërtetë dhe me themel, me një arësim krejt kombëtar. Kaa me ardhunë një ditë, dhe nuk është e largë, kur këta djem të bekuëmunë gjithë shpresë dhe gjithë fuqinë të-palejuemunë me ndjenjat ma të nalta dhe ma të fisshme, të-pajue-munë me një atdhesie dhe me një ideal të-vërtetë kanë me u përveshu-në si burrat me durim të hekurtë në luftë të-pareshtunë, në atë punë të perëndiëshme, prej së cilës kanë me rrëjedhun kaqë të mira për kombin t'onë dhe mbi të cilën ma se fundi do të themelohet qytetënia, përparimi dhe mbrothësia qi andëron zemra e ç'do atdhetari për atdheun e dashtun.

Mundimet e profesorëve të shkollës Normale. Nuk mundemi të gjejmë fjalë të-mjafta për me lavdëruemun profesorët e shkollës Normale të cilët nuk janë tue kërsyëmun as gja sendi, të-cilët për të-mirën dhe për përparimin e shkollës janë tue bamun theror pushimin dhe prehjen e ditës, qetësiën dhe gjumin e natës. Nga mungesa e librave shtrëngohen të përmbledhin andej e këndej, porsì ajo mbleta puntore mjaltnë e saj nëpër lulet, të-për-këthejnë mësimet e nevojëshme, dhe ma së fundit të krijojnë dhe veç me

një gjuhë të-bukurë dhe të-ambëlë, me një gjuhë po thua të përbashkme qi kupëtohet lehtësisht si prej Toskëve si prej Gegëve. Punë e vështirë me të-vërtetë puna e profesorëve! Do të këndojnë dhe do të gatiten, do të përmbledhin dhe do të shkruajnë, pa mbasandaj kaqi orë po thua rrëshetë do të dirsen mbi polygraf qi t'u pre-gatisin kështu djemvet landën e ne-vojshme. Nga mezi i zemrës dhe nga thellësia e shpirtit i përgëzojmë nga ana e gjithë atdhetarëve kuxoj me thënë për mundimet e fisshme dhe për shërbimet e-mëdha që janë tue bamun në fushë atdhesie. Zoti u dhashtë shëndet dhe jetë të gjatë për të-mirën e gjithë kombit Shqiptaar.


Profesorët dhe nxanësit e shkollës Normale me qeleshe të bardha. Sipas vendimit të komisionit profesorët dhe nxanësit e shkollës Normale vunë mbi krye mbulesën kombëtare, qeleshet e bardha të Gegënis. I lumtë komisionit patriotik! Kështu nga zemra dëshirojmë të shohim gjithënjë kësi punësh, të-cilët përngjallin ndjenjat kombëtare në zemrat e nxanësve dhe u apin të marrin vesh, se, sikurse deri më sot kemi ruajtur kombësin tonë të-pacignuame ashtu edhe paskëtaj de-tyra e-shejtë na e kërkon t'a ruajmë sikurse na kaa hie ndërmjet të kom-beve qi na rethojnë.

URA E SHKUMBINIT
Elhasan, 4 (17) Mars 1910

(Gazeta «Tomorri» Nr. 1 - 10,23
Mars 1910)



Një pjesë e pedagogëve të parë të shkollës Normale



Nxënësit e vitit 1909

(Nxënësit kosovarë të Shkollës Normale kthehen nga Elbasani në vendet e tyre në mbarimin e vitit të parë shkollor)

Nxënësit e Shkollës Normale

Me të nisur nxënësit e shkollës Normale nga Elbasani, klubi Shqip i atij qyteti çoi një tejskrim në klub tënë këtu, i cili mori masat që duheshin për të pritur këta djem, për të cilët është varur shpresa e përparimit të ardhmes. Me t'arrirë në Manastir, klubi atjeshëm i priti dhe i përcolli për në Selanik dhe hoqi një tejskrim klubit tënë ku i lajmonte se sot përcollëm nxënësit e shkollës Normale. Me të marrë tejskrimin nga Manastiri komisioni doli në stacion dhe i priti me gëzim të math, i hipi që të gjithë (ishin 38 djem nga Shkupi, Ipeku, Gjakova, Vëlçëtrini, Gjilani e nga shumë vise të Shqipërisë sipërme) në karoca dhe i sollë në klub ku ndenjën

një orë pastaj i shëtitë nëpër qytet, ku gjithë bota i shikonin me vërejtje se në krye të tyre mbanin kësulata e bardha kombëtare, pastaj u dha darkën dhe flejtën në një hotel që ish pregtatur, u bleu dhe 4 palë roba atyne nxënësve që kishin petkat (robat) e grisura dhe 2 palë këpucë.

Të nesërmet komisioni mori djemtë dhe i përcolli gjer në stacion, ku me gëzim i vuri në shëmendëfer të Shkupit në një vagon dhe një nxënësi i nxori dhe biletën gjer në Shkup. Në vagon nxënësit për të çpërblyer e për të gëzuar komisionin e gjithë shqipëtarëvet që gjëndeshin në stacion kënduan 3-4 këngë me zë të bukur sa disa nga dëgjonjësit derthnë lottë nga



Luigj Gurakuqi dhe Aleksandër Xhuvani vijnë për në Elbasan më 1909

gëzimi. Komisioni i klubit mbaroi në bënë të pëlqyerë dhe me të tepër kënaqi gjithë zemrat e nxënësve dhe të shokëve, prishi po-thua 600 grosh. Kuvenduam me disa nga nxënësit dhe mbetëm fort të gëzuar, se në një kohë aqë të shkurtër kanë përparuar fort shumë. Kjo gjë u detyrohet mësojëset, të cilët akështojnë për të lëvduarë. I pyetëm e mbenë të kënaqur nga mësimet, sjelljet e mësonjëset dhe të kujdestarëvet dhe a kishinë rojtje të mirë, na u përgjegjën se ata që na kanë

bërë Profesorët, kujdestarët e gjithë njerëzia n'Elbasan s'na i kanë bërë kurrë prindërit tanë. Kemi shpresë se këta lastarë, këta bij të Shqipërisë prej të cilëve pret ndriçim dhe lulëzim kombi shqiptar dhe Shqipëria do të mos shkojnë kohën' e tyre me të kot, po do të përhapin dritën e diturisë ndër gjith' ata shokët e tyre që janë n'errësi e në padije.

(Marrë nga gazeta «Lirija» —
Nr. 94 — 10 Korrik 1910)



Pedagogu i Normales patrioti Sali Çeka

Provimet e botëshme të Shkollës Normale e shqipe n' Elbasan

(Fjala e Z. Luigj Gurakuqit)

Zotërinj të nderëshëm,

Shtatë muaj ma parë, n'atë ditë fatbardhe e të paharruarshme, në të cilën u hapën dyert e kësaj Shkollë Normale e u vërtetuan kështu shpresat e ushqyeme prej sa e sa vjetësh në mest të brengëvet e të pësimevet, e u-mbushëm me 'të dëshirat e flakta të zembravet shqyptare, u-mundova të çquanja e të kufisonja mirë përpara zotëriës s'uajë nevojen e madhe që kaa kombi i ynë për pësim e dituninë, e të ju dëshmonja e të ju rrëfenja ndë pakë fjalë se, për t'arrimun ma shpejt qëllimin t'onë e për t'a bamun mësimin ma të lehtë e ma të fitimshëm, lypsej që mësimi të ipej në gjuhën e mamës.

Sot që kemi nderin të ju shohim përsëri të mbledhunë në këtë vënd të bekuarë, në këtë çerdhe të dituriës shqyptare, shpresojmë se, nuk do të ju mbaj më ma vetëm me fjalë të gjata e të thata, po do të mundohemi të ju vërtetojmë, me vepra e me tregime, mendimet e fjalët t'ona e të ju japim një provë të vogël po të kthjelltë të dobiës e të frytit që sjell ky lloj mësimi tue ju shtrumun përpara pemët e reja të kësaj vjete shkollore. Mos u mërzitni pra, o zotërinj të nderëshëm, po të kini mirësinë e të na ndëgjoni me durim e me vërejtje, e mos na kurseni ndjesën t'uajë përdëllimore dhe në qoftë se puna nuk do t'i përgjigjet kur do herë të gjitha dëshirave t'uaja.

Të ju thomi të vërtetën, o zotërinj të nderëshëm, si unë si shokët e mij kuur erdhëm këtu që të derdhnim

djerësën t'onë në këtë shkollë shqype, ishim, po-thua, si pak të trembunë pasi që e dinim mirë barrën e randë, që mirrnim përsypri përpara kombit e përpara njerëzisë.

Jo, që puna na frikësonte, jo që mundimi na vinte i vështir, e dinim se, do të punonim për gjuhë e për atdhe, e siç e ka detyrë ç'do shqipëtar i vërtetë, e ky mendim na ngrohte zembëren e na jipte guxim e durim; po vetëm kishim frikë se nuk do të munt t'a mbaronim detyrën e nuk do të mund t'a kryenim siç lypsej, barrën, t'onë, e se shkolla nuk do të bante atë përparim, që zembërat e të gjithëve dëshironin.

Po sot gëzohem të ju dëftoj, o zotërinj të nderëshëm se puna, me ndihmën e Zotit e të atdhesisë së shqyptarëvet, i kapërceu shpresat t'ona. Shqypënia u lëkunt e tanë nga zani i Shkollës Normale; atdhetarët shqyptarë, që prej sa kohe kishin një etje të madhe për mësim e për dituninë, nuk i kursyen ndihmat e vetë të begata, e djemt t'onë rrodhën nga të gjitha viset e Shqipëniës, e u-derdhën këtu n'Elbasan, kështu që sot munt të thomi me një pëlqim të parrëfyeshëm se këjo shkollë, e cila u jap e u-nis nga vetëm 50 nxanës, sot kaa të shkrojtunë ma tepër se 150 të ndarë në katër rende, një të shkollës fillore e trie të Premtares! E jo vetëm nga Toskëria, që ka qenë gjithë monë e para ndë tregimet kombëtare e ndë luftat e gjuhës, po ma fort nga Gegënia e sy-përme, nga ajo Kosova fisnike e trimoshe, me të përpjekunit e të nderëshmit Hasan be Prishtina i cili na rroftë

për jetë, na erdhën mjaft nxanës, sa që munt të thohet, pa frikë lajthimi, se nuk kaa kant të Shqypëniës, që mos të ketë këtu mbrenda përfaqësonjësin e tij.

Po ndonse fitimi i sivjetëshëm kje i math, ndonse po thomi përsëri puna i kapërceu shpresat t'ona, na nuk duhet të kënaqemi me kaq, lypset të kërkojmë ma e ma tepër, lypset të shëkojmë si e si munt të përmirësojmë gjendjen e shkollës s'onë tue i mbushun të metat e mungesat që kaa. Gjaja ma e randësiëshme, e që na lypset ma tepër sot për sot asht ndërtesa për shkollën; kemi nevojë të madhe e pothua të domosdoshme për një shtëpië të gjanë e të shëndetshme, që t'i përmbledhë të gjithë nxanësit, pse, pa këtë, as rregulla as shëndeti nuk munt të ruhen ashtu si duhet. Atdhetarët shqypëtarë lypset të përkujdesen për këtë gja; burrat t'ona të çquarë duhet të marrin masat e nevojëshme e të përpiqen për të hedhur themelet e tempullit të dituniës kombëtare! Të përmbajtunit e përparimi i shkollës Normale janë, o zotërinj të nderëshëmë, të lidhunë me nderin kombëtaar të shqipëtarëve: për këtë shkollë nuk duhet të na dhimsen as puna, as mundimi, as gjaja, as jeta; pse, ndë kjoftë se asht e vërtetë fjala që shenja ma i math e ma i dukëshëm i një kombi asht gjuha, edhe këjo shkollë asht pra shtylla e kombësiës s'onë, mbasi këtu mbrenda do të rriten me urtië e do t'ushqehen me mësim e ditunië ata apostuj shqypëtarë, që për së shpejti do të përndajnë dritën në të gjitha viset e vendit tonë.

Tue kjenë puna kështu, e pas që nisja kje e mirë, kemi arësye të shpresojmë se atdhetarët shqypëtarë, të cilët në kohën e mallkuar të tiraniës, vuajtën pësime gjithë farësh e u-baan therorë për gjuhën e vetë, sot nën hijen e lirisë e nën mbrojtjen e

Konstitucionit nuk do të kursehen t'i ndihmojnë me çfarëdo mënyre e mjeti të nderëshmes shoqërië «Përparimi» të Korçës, e cila po përpiqet me një vullner të lavduarshëm për përmbajtjen e kësaj shkolle e të shumë të tjeravet.

Përpara se t'i jap fund kësaj fjale, e ndjej për detyrë t'i falenderit si komisionit të shkollës edhe parësiës e të gjithë njerëziës s'Elbasanit, që aqë fort janë munduarë të na ndihin në të kryemit e barrës s'onë. Elbasanij përveç se truni e zembëra e Shqypëniës do të jetë paskëtaj për të gjithë nec edhe si një vent lindjeje i dytë. Nxa-nësit e kësaj shkolle, nashti që do të këthehen në vendet e në shtëpiat e veta besonj se do të sjellin me vehte një kujtim të mallëngjyeshëm për këtë qytet të nderëshëm e do të përhapin e do të përndajnë namin e tij në të katrë anët e atdheut tonë.

Rroftë pra Elbasani, djepi i mësimit e i dituniës kombëtare, Zoti i madh i a lehtësoftë me ndihmën e tij të fuqishme të ligën e zjarrit, që i slli në këto ditë aqë shumë dam e që kje një zië e madhe për të gjithë nec!

Mbasi fjala u-mbarue me një trokitje duerësh duel zoti Qamil Çelirama, një nxanës i vogël e na këndoi ligjiratën. Kjo fjalë e sbkurtën e këtij të vogëli me dorësime e me një za të mallëngjyeshëm, me të vërtetë na theu zemrat ene shumë vetë pa dashun mbushën syt me lot.

Mbas kësaj fjale u nisën mësimet rriesbt, Lauzi i gjithë u çudit kur pa për herën e parë vegëlat fysike e qimike me të cilat nxanësit dhanë provimet e tyne dyke i përdorunë fort bukur.

(Gazeta «Lirija» Nr. 94 —

10 korrik 1910)

50-vjetori i Shkollës Normale (1909-1959)

(Kujtime të një nxënësi të vitit 1909)

Për ata që e masin historinë vetëm me data e me shifra, do t'u duket e tepërme që ne e festojmë me kaqë bujë e entuziazëm 50-vjetorin e një shkolle të mesme, kurse bota ka shekuj që ka universitete... Të këtillë njerëz jo vetëm që nuk duhet ta njohin mirë historinë e popullit tonë, por duhet të jenë edhe nga ata që nuk na duen të mirën, qyshse nuk thellohen me kërkue me dijtë se ç'bante populli shqiptar atëhere kur popujt e tjerë t'Evropës krijonin shtete dhe merreshin me kulturë dhe me ngritje shkollash e universitetesh. Nuk mund të mohohet prej kurkujt se populli shqiptar, me Heroin e tij Skenderbeun në krye, luftoi 25 vjet rrjesht për me u pre hovin hordhive turke që synonin me pushtue Europën dhe me shlye qytetnimin e saj.

Nuk mund të mohohet gjithashtu se zgjedha afër 500-vjeçare turke, randoi mbi popullin shqiptar ma tepër se mbi çdo popull tjetër, që u dergj nën sundimin otoman, dhe si rrjedhim ne u damtuem ma tepër edhe në lamin kultural. Veç të tjerave, neve na u mohue edhe e drejta ma natyrale, ushtrimi i gjuhës amtare, pa mos përmendë pastaj sakrificat dhe heroizmat që janë dashë për të ngritunit dhe për të mbajtunit e kësaj shkolle gjatë këtyre 50 vjetëve. Me këtë masë të drejtë e të saktë e mat populli shqiptar këtë përvjetor shumë të randësishëm, dhe me siguri kështu do të mendojnë historianët e ndershëm dhe të gjithë miqt e së drejtës e të popullit tonë. Dëshmi e gjallë për me e provue randësinë e kësaj shkolle janë ata që e kanë jetue atë kohë; asht profesori i saj, që rron ende, patrioti Aleksandër Xhuvani; jemi na, nxanësit e parë të saj. Si njani nga nxanësit e parë të kësaj shkolle, edhe unë, po përpiqem me përshkrue kujtimet e mia e me provue rolin që ka luejtë kjo shkollë në lamin kombëtar e kultural.

Për na, të rinitë patriotë t'asaj kohe, oe një ngjarje me shumë randësi të hapunit e Shkollës Normale, sidomos për ne elbasanasit, që e kishim në qytetin tonë. Vetëm ma vonë, kur u ba greva për të drejtën e gjuhës shqipe në shkollën Idadije, e kuptova sepe im-atë, që ishte nga patriotët e mirë t'Elbasanit, nuk më kishte lejuë qysh në fillim për me u regjistruë n'atë shkollë. Mbas pak ditësh të hapjes së Shkollës Normale, ne, nxanësit e shkollës turke Idadije t'Elbasanit, bamë grevë dhe kërkuem që të mësohesh n'atë shkollë gjuha shqipe, sic premtohesh në shpalljen e Hyrijetit. Greva vazhdoi disa ditë, dhe në këtë rast u bana krahu i diathtë i Min Motraxhiut, që ishte udhëheqësi ynë dhe nga inisiatorët e grevës; por kjo asht një veprimtari tjetër patriotike, që meriton të trajtohet më vehte.

Më në fund m'u realizue dëshira: u bana nxanës i Shkollës Normale, por nana ime qante, pse i thoshin që djali yt e humbi avenirin, qyshse shqipja nuk t'ep bukë, e tjera. Kjo ishte pema e propagandës turke,

që e kishte halë në sy atë shkollë që po bahesh djepi i kulturës dhe i patriotizmit. Në shkollë ishin nxanës nga të gjitha viset e Shqipnisë, shumica kosovarë. E dominin njani-tjetrin me shpirt, mbasi na lidhte një qëllim dhe një ideal, çlirimi i Atdheut; sepse urreheshim dhe ndiqeshim nga një armik, xhon-turqit dhe veglat e tyre. Ishte i madh ndryshimi i shkollës sonë me atë të Idadijes, dhe në çdo drejtim. Profesorët, që ishin Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Aleksandër Xhuvani, Peter Dodbiba, Simon Shuteriqi, Dhimitër Papparisto, Hasan Mezja, etj., metoda e mësimit, mjetet e mësimit dhe çdo gja tjetër, nuk kishin asnjë barazim me atë t'Idadijes. Por ajo, që gëzonte patriotët dhe tërbonte okupatorët dhe veglat e tyre, ishte edukata patriotike që merrnin në këtë shkollë nxanë-nësit e ardhun nga të katër anët e Atdheut tonë. Kjo edukatë patriotike po i epte frutet pa u mbarue viti shkolluer, qyshse Avni Rustemi la bankat e shkollës dhe shkoi në Shkodër për me vra Shefqet Durgut Pashën, që po i vinte zjarrin Kosovës e po vriste e digjte popullin e asaj krahine. vetëm e vetëm pse kërkonte liri e pamvarësi. Në provimet e përbotëshme (të hapëta) ku ishin ftue me qindra njerëz, u çfaqën ma së miri rezultatet e shkëlqyeshme të kësaj shkolle në çdo drejtim dhe treguen epërsinë e saj ndaj Idadijes. Eksperimentet fiziko-kimike dhe manifestimet e tjera shkencore e patriotike i kënaqën shumë asistuesit e këtij provimi, dhe m'anë tjetër banë të tërbohen xhon-turqit e këlyshët e tyre, që ndodheshin aty si të ftuem. Ata i tërboi ma tepër fjalimi, në gjuhën turke, që mbajta unë. Ky fjalim ishte përgatitë nga udhëheqja e Klubit dhe e Shkollës, dhe përmbante kritika aq t'ashpra kundra xhon-turove dhe politikës së tyre, sa që menjëherë mbas fjalimit tim e mori fjalën Kryetari i Klubit Ittihad ve tereki, kapiteni Shefki Beu, tue u mbrojtë e tue kundër-sulmue. Fjalimi im u botue n'atë kohë në gazetën «Bashkimi i Kombit» që dilte në Manastir në gjuhët shqip-turqisht.

Mbarimi i shkollës u mbyll me sukses e me entuziazëm. Studentët e ardhun nga vise të ndryshme t'Atdheut u përcuellën nga populli i Elbasanit po me atë përzemërsi e dashuni që cenë pritë e mbaitë kur erdhën në qytetin tonë. Këta studentë, që u shpërndanë nëpër viset e familjet e tyre për me ba pushimet e verës, u banë agjitorët ma të mirë për të përhapunit t'idesë kombëtare dhe të gjuhës shqipe, dhe për me provue epërsinë e Shkollës Normale ndaj shkollave turke. S'ka dëshim se, po të mos ndodhte operacioni i Durgut Pashës, që ndër të tjera mbylli dhe shkollat shqipe, Shkolla Normale do ta shumëfishonte kapacitetin e saj, sidoqë ishte në plan të hapeshin edhe shkolla të tjera si ajo. Por xhon-turqit e ndien rrezikun dhe e kuptuen se ç'kuadro të shëndosha do të rriteshin dhe do të edukoheshin në këto shkolla, prandaj shpejtuen në të mbyllunit të tyre. Qe shkaku i Shkollës Normale ai që bani të jetë ma i ashpër n'Elbasan operacioni i Durgut Pashës në Elbasan u burgosën dhe u torturuen ma shumë se në vendet e tjera, tue shtie si pretekst se viktima kishte një pushkë-mauzer —, dhe ky mauzer nuk ishte tjetër veçse djali i tij që kishte pasë si nxanës në Shkollën Normale.

Xhon-turqit kishin të drejtë, sepse, siç u provue edhe ma vonë, gjatë këtyne 50 vjetëve, kjo shkollë rriti dhe edukoi kuadro, që u banë ma tepër se topa e mauzera, u banë revolucionarë të vërtetë. Me frymën e kësaj shkolle u rrit Avni Rustemi me shokë, që luftuen për çlirimin e Atdheut nga zgjedha shekullore turke; luftuen mbas shpalljes t'indipendencës më 1912 — kundra armiqve të mbrendëshëm dhe të jashtëm, dhe për një Shqipni për popullin dhe pa bejlerë e tradhëtarë.

Sikurse nga xhon-turqit gjatë okupacionit otoman, Shkolla Normale u urrye dhe u luftue edhe gjatë regjimeve antipopullore dhe okupacioneve të mavonëshme, por me metoda dhe mënyra të ndryshme. Populli i Elbasanit si edhe mbarë populli shqiptar, patriot e revolucionar, e mbrojtën me guxim shkollën e tyne laike nga obskurantistët dhe nga agjentët e anmiqve të jashtëm. Qenë të shumta tentativat e bame gjatë regjimit të Zogut e gjatë okupacionit italian për mbylljen e transferimin e kësaj shkolle, por pa sukses. Ajo vazhdoi të jetë çerdhe kulture e patriotizmi edhe gjatë kësaj periudhe të vështirë, tue i dhanë Atdheut dhe luftës nacional-çlirimtare mjaft kuadro të shëndosha. Këtë e provuen demonstratat e manifestimet e bame nga nxanësit e kësaj shkolle, këtë e provuen dëshmorët që dha ajo për luftën nacional-çlirimtare.

Kjo asht historia e shkëlqyeshme e kësaj shkolle 50-vjeçare, prandaj ne e festojmë me kaq gëzim e harë këtë përvjetor. Nxanësit e kësaj shkolle me tradita kaq të shkëlqyeshme, duhet të jenë kryenaltë që kanë fatin me e frekuentue këtë, ashtu siç janë kryenaltë e të lumtun ata që kanë dalë prej kësaj shkolle, sidomos ata që ushtrojnë profesionin e naltë të mësuesit. Tue e dijtë mirë historikun e shkollës dhe sidomos heroizmat e sakrificat që janë dashë për themelimin e të mbajtunit të saj, juve, mësues të dashun, do t'ju duken shumë ma të lehta vështirësitë që hasni në të kryemit e misionit tuej të shejtë. Po të mendoni se nanat tueja nuk qajnë, si ato tonat në atë kohë, nga frika se shqipja nuk t'ep bukë, por gëzojnë frutet e punës suej; po të mendoni se baballarët tuej nuk burgosen e torturohen si ata tanët n'atë kohë, pse kishin çue djalin e tyne në këtë shkollë, por nderohen e respektohen si baballarët e mësuesit; dhe po të mendoni, ma në fund, rreziqet që i ndiqnin ata nxanës që frekuentonin këtë shkollë n'atë kohë, nuk do t'ju duken asgja vështirësitë që hasni në të kryemit e misionit tuej, sidomos ju, mësues të dashun të katundeve, por do të shumëfishoni forcat tueja për me kontribue në misionin e naltë që ka marrë Partia e pushteti, për të zhdukun ndryshimin midis fshatit e qytetit.

Ky përvjetor qëlloi bashkë me festën e madhe të XV-vjeçarit të çlirimit t'Atdheut tonë të shtrejtë. Me këtë rast u ba bilançi i fitoreve tona 15-vjeçare, që provon ma së miri atë që u tha në fillim: «historia nuk matet me data e me shifra». Ato që u banë në vendin tonë gjatë këtyne 15 vjetëve janë dashë shekuj me u ba në vendet kapitaliste. Dhe, me siguri, shkolla jonë 50-vjeçare e universiteti ynë pakë-vjeçar do t'i kalojë shkollat me tradita shekullore, n'asht se këto të fundit qëndrojnë gjithënjë në pellgun e kapitalizmit.

Me rastin e këtij përvjetori të shkëlqyeshëm duhet të falenderojmë edhe një herë nga zemra Partinë e pushtetin tonë popullor për randësinë e madhe që i kanë dhanë arësimit e kulturës, dhe t'u premtojmë, sidomos ju, nxanës e arësimitarë të dashun, se do të punojmë me mish e me shpirt për të kryemit e misionit tonë, sidomos për të zhdukun ndryshimin midis fshatit dhe qytetit, dhe se do të tregohemi të denjë për me i mbajtë lart traditat e kësaj shkolle.

QAMIL ÇELA



Ndërtesa e Normales më 1909-1911.



Në këtë ndërtesë përgatiten tani kuadro për arësimin tonë popullor

Një fletë nga ditari i kujtimeve

Ishte një ditë e bukur vere. Natyra qeshte me tanë shkëlqimin e saj. Die-lli i mëngjezit të 25 qershorit të vitit 1910 me rrezet e tij t'arta shndriste pa kursim qytetin. Në rrugën kryesore të lagjes Beqire (Beqir Celepi) shifesh një lëvizje ma e madhe se çdo herë tjetër; këtë radhë rrugën e mbushnin patriotët, nacionalistët, që grumbulloheshin në klubin «Bashkimi» dhe prisnin me padurim një orë të caktueme për t'asistue në një ceremoni, e cila bante pjesë në kuadrin e qashtëve kombëtare.

Oborri i Shkollës Normale t'Elbasanit gumëzhinte si bleta nga gjallnia e nxanësve fytyrë-çelë, syqeshun e buzëgaz, që përgatiteshin e inkuadroheshin për të pritur të ftuamit, Sallo-ni i madh i shkollës në katin e dytë ishte stolisë ma së miri. Gjatë sallës ishin renditur rrjeshtat e karrikeve dhe përballë tyre tryezat me disa nga aparatet e laboratorit të shkollës si dhe një dërrasë e zezë.

Këto mjete mësimore, të porosituna jashtë shtetit, n'ato kohë u tërhiqnin me të vërtetë mëvendjen spektatorëve e i banin kureshtarë, se deri aso kohe nuk kishin ekzistue as nëpër gjimnazet shtetnore të katër vilajeteve të Shqipnisë.

Atë ditë e para shkollë e mesme shqipe, Normalja e 1909-ës, bante ceremoninë e mbylljes së vitit shkolluer 1909-1910, tue u dhanë rastin të ftuemeve të shofin edhe nga një provim-tip të landëve kryesore; kështu do të pasqyrohesh i tanë mundi, e tanë puna me përpjekjet e sakrificat e personelit mësimor si dhe të nxanësve, t'atyne filizave që në t'ardhmen e afërtë do t'ishin punonjësit e denjë t'arësimit të popullit.

Profesorë e nxanës ishin veshun me rrobet e festës. Qeleshja e bardhë elbasanase mbi kokë ishte e vetmja

divizë, që i karakterizonte se ishin misat e Shkollës Normale shqipe.

N'orën 8,30' u fut në portën e oborrit komisioni i shkollës; i pritun nga profesorët ai hypi naltë e zunj vend. Mbas pak bani ballë kryesia e klubit «Bashkimi», paria e qytetit, patriotët e çquem të vendit, prindët e nxanësve, etj., të pritun nga drejtori i shkollës Luigj Gurakuqi, profesorët Aleksandër Xhuvani, Sotir Peci, Hajdar Blloshmi, Peter Dodbiba, Simon Shuteriqi, etj. Pak minuta para se të fillonte ceremonia, afërsisht n'orën 8, 50' hynë në portë autoritetet civile e ushtarake qëveritare, të primun nga Mytesarif Pasha (prefekti), nga Liva Pasha (gjeneral-major), komandant i garnizonit ushtarak me oficerët e shtabit, komandanti i gjindarmërisë, kryetari i gjyqit me gjykatësit, drejtori i financës, etj. Midis autoriteteve civile bante pjesë edhe drejtori i gjimnazit turk t'Elbasanit, Ali Riza Efendi, njeri përparimtar, i partisë ahra-re (liberale) turke bashkë me profesorët e asaj shkolle.

N'orën 9 del në tribunë drejtori i shkollës, Luigj Gurakuqi, i cili midis duartrokritjesh frenetike, hap mbledhjen ceremoniale me një fjalim shumë prekës, tue vue në dukje vështirësitë e hasuna si viti i parë i shkollës së kësaj natyre, përpjekjet vetmohuese të personelit mësimuer e të studentëve, sukseset e arrituna gjatë këtij viti shkolluer, etj. Këtij fjalimi të zjarrtë i epte një hijeshi të veçantë edhe e folmja shumë pak e belbët e Gurakuqit, që i bante ma tepër tërheqëse ato shprehje plot shpirt e gjallni.

Këtu Luigj Gurakuqi epte të parin raport të së parës shkollë të mesme shqipe, e sidomos nën një regjim të huej. Fjalët ishin sa të guximëshme aq dhe kuptimplotë.

Kjo analizë e hollësishme e punës vjetore me rezultatet e shkëlqyeshme

t'arrituna u prit dhe përfundoi me duartrokkitje të stuhishme. Pastaj u kalue në pikën e dytë të programit. Filluen provimet-tip të disa lëndeve kryesore.

Turqishtja ishte gjuhë zyrtare e shtetit, prandaj provimi u hap me gjuhë e letërsi turke.

Del në dërrasë të zezë një nrxanës. Profesori i landës, Hajdar Blloshmi, ndër të tjera i ban edhe një diktat me temën Gjez jashi (lot syni), pjesë mjaft prekëse. Shkruhet nga nrxanësi në dërrasë, përkthehet shqip, bahet analiza morfologjike e sintaktike në gjuhën turke, kalohet në letërsi, flitet për poetin e shumë-nojftun për atë kohë, Teufik Fiqretin, recitohet një poezi e tij me titullin «Doksabeshe dogra» (Drejt nandëdhjet' e pesës) e pastaj komentohen vargje e strofa të saj.

Copat ishin të zgjedhuna dhe kishin lidhje të ngushtë me situatën politike të kohës. Përshtypja që lanë ndër autoritetet ishte jashtëzakonisht e madhe.

Këtë e pasoi provimi i gjuhës shqipe, i gjuhës së perendive që prej natyre asht e butë si mëndafshi, e ambël si mjalti dhe e mprefet si shpata, e cila gjatë pesë shekujve të robnisë ish dënuue nga qeveria otomane të mos lavrohesh për të lanë popullin tonë n'errësinën e padijes. Ja, pra, ma në fund, po n'atë regjim, me përpjekjet e pareshtuna të popullit shqiptar, po mësohesh në shkollën e mesme shqipe me pak ndryshim në termat gramatikore me të sotmen si fillik për folje, paravume për fjali, etj. etj.

Nrxanësi i paraqitun për këtë qëllim ndër të tjera shkruen në dërrasë dhe ban analizën e një periudhe të diktue-me, pastaj hidhet në letërsinë shqipe. Flet për poetin e pavdekëshëm të gjuhës sonë. Naim Frashëri, për jetën e veprat e tij, reciton poemën e tij të mirënjoftun «Bagëti e bujqësija», ban komentet e rastit dhe në këtë mënyrë ve në dukje me hollësi madhështinë,

begatinë dhe bukuritë e natyrëshme të Shqipnisë.

Mallëngjimi i të ftuemve mbërrini kulmin, e sidomos ai i patriotëve, që aso kohe Naimin e konsideroni profetin e gjuhës shqipe.

Provimet në gjuhë e në matematikë u ndoqën me vëmendje të madhe nga spektatorët dhe shumë kush prej sish përshpëriste për punën e madhe që ishte bamë gjatë atij viti shkolluer.

Por një interes jashtëzakonisht i madh u tregue në provimin e lëndës së fizikës dhe n'atë të kimisë.

Kur nrxanësi, tue iu përgjegjun pyetjeve, bante eksperimentet në maqinën pneumatike, në gjysmësferat e Magdeburgut e n'aparate të tjera sytë e publikut ishin përqëndrue thellësisht n'ato veprime dhe të gjithë habiteshin se si të gjitha të dhanat viheshin në jetë, tue i provue me anë të këtyne aparateve, që shifeshin për të parën herë në vendin tonë.

Prova në landën e kimisë zgjoi një interes edhe ma të madh. Nrxanësi i paraqitun, tue iu përgjigjun pyetjes së bame, shkrueti formulën në dërrasë e pastaj me anë të mjeteve mësimore të vendosuna mbi tavolinë prodhoi hidrogjen. Gja e padukëshme në të pame; por kur nrxanësi mori epruvetën në dorë e përmbysi mbi hidrogjenin e prodhuem, spjegoi veçorit e tij, afroi një shkrepsë të ndezun në grykë t'epruvetës dhe shkaktoi krizma të njëmbasnjëshme si ato të një revolveri, atëhere eksperimenti i la të habitun gjithë të ftuemt.

Entuziazmi i të pranishmeve kishite arritun kulmin. Këtu nuk e shof të nevojëshme të përshkruej çastet, kur patriotët tanë jetonin në sfera të nalta gëzimi, se kjo ishte ma se e natyrëshme.

Ceremonia zgjati deri në mesditë. Kujtime të 50 vjetëve. . .

ABEDIN ÇAUSHI

Ish-nrxanës i vitit të parë të Shkollës Normale (1909)

DISA KUJTIME NGA SHKOLLA NORMALE

Pesëdhjetë-vjetori i shkollës pedagogjike të Elbasanit (që më parë quhej Shkolla Normale) nuk është një ngjarje e shënuar vetëm për nxënësit e sotëm të saj, që, duke mësuar në kondita të mira, duhet të mendojmë edhe për vështrirësitë e paraardhësve të tyre, por edhe për të gjithë nxënësit e vjetër, që, sadoqë sot nuk kemi ndonjë lidhje të drejt-përdrejtë me shkollën tonë të vjetër, e ndjekim me kureshtje dhe keqësi çdo përparim të saj. Bile ky është një përvjetor i shënuar për gjithë arësimin në vendin tonë.

Duke dashur të shkruaj disa radhë me rastin e këtij jubileu, mendova se tregimi i disa kujtimeve do të jetë një gjë e dobishme. Hapa ditarin tim t'asaj kohe dhe kujtimet filluan të rrjedhin...

Klasa jonë, maturante e vitit 1938, kishte një farë organizate rinie të sajën që ne e quanim «V.D.V.», domethënë «Vullnet-Detyrë-Vëllazërim». Fjalë të bukura, por që sidoqoftë donin një spjegim. Këtë detyrë e ka kryer profesori kujdestar i klasës P.A. më 25 janar 1936. Si shembull vullneti ai ka marrë milionerin amerikan Ford; si shembull detyrë ka marrë ish presidentin amerikan Linkoln dhe për të konkretizuar vëllazërinë ka folur për «dëshirën që ka njeriu prej natyre që të shoqërohet me të tjerë». Shikoni çfarë idealizmi me brirë na mësonte një profesor, i cili më vonë përfundoi në radhët e tradhëtarëve me damkë! Përkundrazi sa mirë është sot kur mund të mësosh se Fordit nuk do t'i mjaftonte vetëm vullneti për t'u bërë milioner, por duhej të përdorte edhe çfrytëzimin në masë të të tjerëve; se Linkolmi që vërtet një njeri i madh i epokës së tij, por nuk qe aq shumë ndienja e detyrës ajo që e shpuri në postin e presidentit t'Amerikës se sa fakti që tek ai, në një çast të caktuar, u personifikuan aspiratat e Amerikës s'asaj kohe; se njeriu vëllazërohet e shoqërohet jo nga «dëshira e tij», por se kjo është një konditë e domosdoshme që ai të jetojë.

Çfletoj fletët e ditarit dhe ve re se në janar e shkurt 1936 kam lexuar librat «Tre muskëterët», «Zonja me Kamelië», «Të mjerët», «Konti i Montekristos», «Dashuri e kryqëzuar» dhe një biografi të shkurtër në frëngjisht të Stalinit, që e qarkullonim fshehtazi dorë në dorë. Siç shihet, për një djalosh që sapo i kish mbushur 16 vjeçët, leximet ishin pa një kriter të caktuar. Dhe mendoj, sot-23 vjet më vonë, për fatin e mirë që kanë të rinjtë e ditëveve tona që të kenë në dorë libra shumë të mira të botuara gjatë pushtetit popullor. Midis përkthimeve të asaj kohe të «Tre musketerëve», etj., të cilat bëheshin më shumë për qëllime tregëtare, dhe përkthimeve që bëhen sot të veprave më të mira të letërsisë botërore, ka një ndryshim aq të math sa vetëm qorrat nuk e shohin. Dhe bëjnë gabim të madh ata të rinj që sot nuk lexojnë libra, sa më shumë libra.

Më 27 shkurt 1936 kam shënuar ndër të tjera: «Populli ndodhet në gjëndje të mjerueshme dhe nuk do të dalë nga kjo gjëndje veçse kur kapitalistët ta humbasin fuqinë që kanë». Dhe të nesërmen, më 28 shkurt, e kam filluar ditarin kështu: «Sot zoti K.B. na këshilloi të mos lexojmë gazeta, të mos merremi me politikë». Nga ditari mësoj se ato ditë bënte ftohtë, kish rënë edhe dëborë. Në rrugë më 27 shkurt kisha parë një njeri gjysëm lakuriq, që dridhej nga cikma e dimërit dhe pikërisht në këto rrethana, profesori i pedagogjisë na porosiste të mos mirremi me

politikë. Po atë ditë sjellin n'Elbasan Dhimitër Shuteriqin dhe një nxënës tjetër të Liceut të Korçës të lidhur me hekura dhe të shoqëruar me xhandarë. Kjo është mjaft për të patur idenë e kohës, t'asaj kohe kur, ndërsa populli vuante, rininë përpiqeshin ta veçonin nga jeta, ta edukonin me idealizëm fallso, në mënyrë që ajo të mos i shërbente popullit të vet, por një grushti gjakpirësish, që ja kishin shitur vendin tonë Italisë fashiste të Musolinit.

Dhe ja, më 30 maj 1936 gjej këtë shënim: «Flitet këtu në Elbasan se studentët italianë të universitetit kanë bërë në disa qytete të Italisë manifestime tue shëtite udhëve e tue thirrë: «si hakmarrje për humbjen e Aduas (Abisini) e pushtuam Abisininë dhe si hakmarrje për humbjen e Vlorës duam kolonizimin e Shqipërisë». Më tej ndër shënime gjej projektin e një thirrjeje që do t'u drejtohej nxënësve me rastin e një kundër-manifestimi që do t'organizohet më 3 qershor në orën 12 dhe pastaj u bë më përpara, më 2 qershor, në orën 17. Por në shënimet shikoj edhe se janë bërë disa arrestime dhe manifestimi ka dështuar. Ja, pra, si ndodhte n'ato kohë; e varfëronin, e torturonin popullin, ja shitnin vendin fashizmit italian dhe në shkollë të mësonin që të mos mirreshe me politikë. Po vallë ajo që bënin ata nuk ishte politikë? Dhe çfarë politike e ndyrë, antinacionale, antipopullore! Jo, shokë të rinj, që sot jeni në bankat e shkollës! Ju duhet të fletëni me politikë. Ju duhet të dini çdo gjë mbi të kaluarën, të tashmen e t'ardhmen e Atdheut e të popullit tuaj dhe të vini gjithë dijeninë, entuziazmin e rinisë dhe aftësitë tuaja që të zbatohet drejt dhe deri në fund politika largpamëse e Partisë s'onë të Punës, politika e ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit.

Një vit më vonë, më 1937, gjendja ishte po ajo. Më 16 prill 1937 isha duke lexuar disa gazeta në bibliotekë. Për një çast bëhet zhurmë, sepse hyn një plak e pyet se mos është aty bashkia e qytetit. Shërbyesi i bibliotekës me një të shtyrë e nxjerrë jashtë. Unë le gazetën dhe vrapoj ta takoj. Dhe në ditar kam shënuar: «E arriva; e pashë mirë; po ç'të shifje? Mizerje: zbatëhet, pa rrobe, me një gunë të lecosur» dhe më tej: «E pyeta prapë: «Ç'do në bashki?» — C'due? Due bukë» — tha me një gjysëm zani — e pa vazhdue ma gjatë ngau nga bashkia, ku shpresonte të gjejë bukë. A gjeti bukë atje? Kush e di! Unë nuk besoj».

Po të vazhdoj kështu, me kujtimet që më ngjall ditari, e shoh në do të vete shumë gjatë. Por sidoqoftë më duhet patjetër të shënoj këtu se midis shënimeve të shumta për të zezat e kohës ka edhe ndonjë notë gëzimi. Shoh në ditar shënimet çmimi e respekti për profesorin e sapo-ardhur K.P., për profesorin e vizatimit Z.K. bashkë me të cilin edhe ne nxënësit jemi gëzuar kur krijoi familje dhe jemi hidhëruar kur gruaja i vdiq para kohe. Gjej në fletët e ditarit shumë shënime për shëtitje të shkurtëra e të gjata dhe për sportin, e sidomos për atletikën. Dhe, të them të drejtën, më duket se shokët tanë të rinj, që sot mësojnë në shkollat e mesme, u kushtojnë pak vëmendje dëfrimeve të tilla, që japin shëndet dhe e bëjnë jetën të gëzuar.

Por në përgjithësi në ditarin tim t'atyre vjetëve mbizotëron një notë e zezë. E tillë ishte koha, e tillë edhe gjëndja jonë shpirtërore, e të rinjve t'asaj kohe. Dhe kështu vazhdoi deri në pushtimin e vendit tonë nga fashizmi italian. Por edhe okupacioni, me gjithë përpjekjet për t'i dhënë një llustër të bukur gjendjes, natyrisht nuk bëri tjetër veçse e shtoi mjerimin dhe ne shqiptarët humbëm lirinë nacionale, pa të cilën nuk mund të pritej asgjë e mirë.

Vetëm lufta nacional-çlirimtare, e udhëhequr nga Partia jonë e dashur, dhe e lidhur me luftën e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë si dhe me luftën e të gjitha forcave antifashiste, bëri të mundur që të çlirohej atdheu, të vendosej pushteti i popullit, të ndërtohej Shqipëria e Re.

Kushtrimit të Partisë për luftën nacional-çlirimtare i u përgjigjen dhjetra nxënës dhe ish-nxënës të Shkollës Normale, që rrokën armët për të luftuar okupatorin e tradhëtarët. Shumë të tjerë e simpatizuan dhe e ndihmuan në forma të tjera luftën për çlirim. Disa nga shokët tanë më të mirë nuk u kthyen nga mali: ata dhanë jetën e tyre të re që të rrojë e lulëzojë Shqipëria. Të bëhet zemra mal kur shikon se sakrifica e tyre e lartë hodhi themele të tilla, mbi të cilat po ndërtohet me sukses socializmi në vendin tonë. Të bëhet zemra mal kur shikon se një varg shokësh t'atyre dëshmorëve janë sot në vendin e nderit, në ballë të përpjekjeve për ndërtimin e socializmit. Unë nuk them dot se i mbaj mënd emërat e të gjithë nxënësve të Normales në kohën kur kam qenë edhe unë nxënës. Aq më pak mund të them për jetën e mëvonëshme. Por a nuk është kënaqësi të shikosh se si bashkënxënësit e një klase kanë qenë bashkëluftëtarë në luftë dhe janë prapë të bashkuar sot në punën ndërtimtare? Unë shikoj se si shokët e mi të klasës Kiço Ngjela, Josif Pashko, Haxhi Kroj, Petrit Hakani, Thanas Nano, Llambro Duka, Jorgji Shuteriqi, Dhimitër Fullani, Enver Palluqi, Dervish Lisi, Esat Bordi dhe shumë të tjerë janë edhe sot në ballë të përpjekjeve për të mirën e popullit. Vë re se lufta i ka rralluar radhët tona. Ajo ka rrëmbyer më të mirët, si shokët tonë të paharruar dëshmorët Mehmet Karadakun, Mehmet Pepën, etj. Ajo ka mënjeluar edhe disa pak vetë, të cilët, ashtu si në shkollë, edhe në jetë çquheshin për natyrën e tyre të keqe, për veset e tyre, për prirjet e tyre të mbrapshta.

Puna që bëj sot, lidhjet me qytetin tim të lindjes, miqësia e përhershme që kam lidhur gjatë luftës me shumë fshatarë të rrethit, më bëjnë të shkoj disa herë në vit në Elbasan. Dhe gjithënjë i hedh një sy ndërtesës madhështore të shkollës pedagogjike, të ndërtuar nga pushteti popullor. Kujtoj vitet e rinisë së kaluar në shkollë dhe i uroj çdo grupi të ri që hyn aty suksese në mësim dhe, çdo klasë që diplomohet, suksese në jetë. Mendoj në ato çaste se për njeriun me ndjenja të pastra, e sidomos për atë që i kushtohet mjeshtërisë së nderuar t'arësimtarit, edhe emëri i nderuar i shkollës ku ai ka marrë mësim, duhet të jetë medoemos një nxitje për të vepruar mirë në jetë. Dhe më kujtohet fjala e urtë e popujve të Lindjes, që thotë: «Kur linde, ti qave por qeshën të tjerët; jeto në mënyrë që, kur të vijë vdekja, ti të shkosh i qeshur dhe të tjerët të qajnë për ty».

SAMI BAHOLLI

Normalistët - pjestarë aktivë në revolucionin demokratiko-borgjez të vitit 1924

Pas kongresit të Lushnjes dhe fitores së popullit shqiptar në Vlorë më 1920, në vitin shkollor 1920-21 rifilloi nga mësimet Shkolla Normale në Elbasan. Vendimi i Qeverisë së Tiranës, që u zgjodh në Kongresin e Lushnjes, u prit me gëzim nga të gjithë patriotët e vendit tonë. Zëri i kësaj shkolle, që lëkundti tërë Shqipërinë, sikurse thoshte drejtori i saj, Luigj Gurakuqi, në fjalimin e mbajtur me rastin e provimeve më 25 qershor 1910, buçiti edhe një herë an' e mbanë Shqipërisë.

Që në vitet e para Normalja e Elbasanit u mbush me djem t'ardhur nga të gjitha viset e Shqipërisë. Nga Gjirokastra e Vlora, Berati e Lushnja, Tirana e Durrësi, Kukësi e Shkodra, nga Gjakova, Dibra, Prizreni dhe krahina të tjera të Kosovës, që të gjithë të rinj të vendosur për t'i shërbyer popullit si mësonjës, kudo që do të hapeshin shkolla shqipe.

Në vitin shkollor 921-922 pranë shkollës u hap për herë të parë dhe konvikti për strehimin e të rinjve që dërgoheshin këtu nga gjithë vendi. Në këtë vit pata fatin të vij edhe unë me bursë të shtetit. Shumica jonë ktheheshin në bankat e shkollës pas një ndërprerjeje të gjatë, për shkak të luftës së parë botërore. Kështu që nxënësit e viteve të para qenë mjaft të rritur, qenë të rinj që kishin vuajtur tmerret e luftës dhe kishin ndjerë thellë shtypjen e pushtonjësve të huaj.

Mjaft nga shokët tanë kishin marrë pjesë në luftën e Vlorës si luftëtarë ose si anëtarë të bandës të qytetit t'Elbasanit, që drejtonte prof. A. Gashi.

Që në vitet e para të kësaj periudhe punonin në këtë shkollë si mësonjës elementë me një të kaluar patriotike, si i ndyri Salih Çeka, që ra nga plumbat e Shefqet Vërlacit, si Ahmet Gashi, që ka shkruar energjitë e tij si mësonjës i gjeografisë, historisë dhe shpesh si mësonjës i muzikës në këtë shkollë, si Kostaq Cipua, i ri entuziast me parime demokratike dhe punonjës i çuar i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, dhe mësonjës të tjerë të dalluar për aktivitetin e tyre arësorimor në dobi të çështjes kombëtare.

Përbërja e mirë e shkollës me nxënësit e me mësonjës nga njera anë dhe traditat e shkëlqyera të Normales dhe vetë të qytetit t'Elbasanit si në përhapjen e gjuhës shqipe dhe të kulturës, ashtu dhe në fushën e patriotizmit, nga ana tjetër, qenë kondita të favorëshme për edukimin e normalistëve me ndjenja patriotike, me dashuri për popullin për gjuhën shqipe dhe kulturën tonë kombëtare. Duke rrojtur në Elbasan në një ambient të ngrohtë nxënësit e Normales filluan të bëhen shpejt pjestarë aktivë në jetën shoqërore, politike dhe kulturele të vendit. Secili prej nesh ndiqte me vëmendje mësimet e pedagogëve dhe në mënyrë të veçantë mësimet e gjuhës

dhe letërsisë shqipe që na i mësonte Kostaq Cipua. Ne e kujtojmë me mirënjohje të thellë profesor Cipun, i cili, duke qenë shpesh afër nesh, si në shkollë ashtu dhe në konvikt, nuk kursehej të na ndihmonte me këshilla e biseda për të kapërxyer vështirësitë në mësim, për të kuptuar qartë e drejt interesat dhe realitetin e vendit tonë në konditat që u krijuan pas luftës së parë botërore. Profesor Cipua nuk na fliste vetëm në orët e mësimave për problemet e vendit, për të kaluarën heroike të popullit; fjalët e tij ne nuk i harruam kurrë. Ne i dëgjuam me shumë interes bisedat e tij për jetën dhe veprimtarinë e të tre yjeve frashërrjotë, sikurse i quante ai Abdylin, Saminë dhe Naimin.

Që në vitet e para të riçeljes së Normales, në Elbasan kishte një lëvizje kulture dhe politike që influencoi tek ne në mënyrë pozitive. Aktiviteti i klubit dhe gazetës «Shkumbini», «Ura e Shkumbinit», etj. qenë për ne një ndihmë shumë e çmueshme për ta njohur realitetin gjithënjë e më mirë. Lufta e ashpër që zhvillohej në Parlament nga deputetët përparimtarë kundër A. Zogut dhe pasuesve të tij, tregonte para gjithë popullit se cilët qenë miqt' e vërtetë dhe cilët qenë armiqt' e tij. Në këto rrethana, normalistët kuptuan se rruga e vetme që ajo që të bashkoheshim me forcat demokratike përparimtare, për të luftuar Zogun, Vërlacin dhe obskurantistët e tjerë, të cilët donin ta kthenin Shqipërinë në një «Turqi të vogël». Dhe këtë qëndrim nxënësit e Normales e çfaqnin pa e drojtur si në shkollë ashtu dhe jashtë saj. Kjo s'mund t'i pëlqente as Vërlacit në Elbasan dhe as pjestarëve të tjerë të Qeverisë, të cilët ishin përkrahësit e politikës së tyre. Për Vërlacin nxënësit e Normales qenë një rrezik për zgjedhjet e afërme që do të zhvilloheshin në dhjetor të vitit 1923. Qysh mund të duronte beu i Elbasanit të propagandonin kundër «oxhakut» të tij para shtëpis së tij «harbutët» e Normales,

që qenë mbledhur nga të gjitha viset e Shqipërisë? Qysh mund të duronte një Kostaq Cipo që s'çante kokën në gjënde, para shkollës ku mësonte ai, një nga bejlerët më të mëdhej të Shqipërisë?

Për të mbrojtur Shefqet Vërlacin dhe për të goditur çfaqjet demokratike të kolektivit të Normales, Rexhep Mitrovica, Ministër i Arësimit, dërgoi në Elbasan dy të deleguarit e tij, Pertef Pogonin dhe Karl Gurakuqin. Këta zotërinj, me çpifje e trillime, me kërcënime e kanosje deshën të diskreditonin profesor Cipun, që respektohej e nderohej më shumë se kushdo tjetër në kolektivin e Normales. Dhe kur panë se nuk mund t'ja arrinin qëllimit, për të cilin qenë dërguar, përjashtuan nga konvikti 3-4 nxënës dhe pezulluan nga puna profesor Kostaq Cipun. Me largimin e prof. Cipos dhe të disa nxënësve nga konvikti, Rexhep Mitrovica kujtoi se normalistët do të frikësoheshin dhe nuk do të përziheshin më në politikë ose të paktën nuk do t'aktivizoheshin në luftën elektorale në dëm të Shefqet Vërlacit dhe grupit të tij. Mirëpo, me gjithë masat, me gjithë kanosjet e kërcënimet, normalistët e shtuan edhe më tepër aktivitetin e tyre për demaskimin e Zogut, Vërlacit dhe të shokëve të tyre, sidomos me rastin e zgjedhjeve parlamentare të vitit 1923.

Në këto zgjedhje, si në mjaft krahinë të Shqipërisë së bashku dhe në Elbasan, u zhvillua një luftë e ashpër elektorale. Grupi i Vërlacit përdori çdo çpifje e intrigë për të frikësuar qytetarët e ndershëm që të votonin për grupin e tij; agjentët e Vërlacit bënë presione dhe kërcënime, bile dhe terror, sikurse që vrasja e Adem Gjini-shit nga Peqini me 22 nëndor 1923. Normalistët e Elbasanit, duke u shkri-rë me masat e popullit, dhanë një kontribut të çmuar në këto zgjedhje. Ata demaskuan pa frikë Vërlacin, mbështetën me kurajo grupin përparimtar të Elbasanit në të gjitha manifestimet, si përpara ashtu dhe pas zgjedhjeve.

Në këto zgjedhje ata panë së afërmi se si përçmohej demokracia dhe të drejtat më elementare nga reaksioni me A. Zogun në krye. Ata panë rrezikun që i kërcënohej vendit, i cili po shkonte drejt diktaturës personale të Zogut.

Këto zgjedhje ndihmuan që të bindeshin se sa të gabuar ishin disa nga shokët tanë normalistë që përkrahnin Vërlacin nga njëra anë; nga ana tjetër faktet e shumta e lehtësuan luftën brenda shkollës kundra atyre nxënësve që vazhdonin të ecnin akoma në rrugën që e shpinte vendin në greminë.

Në vitin shkollor 1923-1924 Normalja drejtohej nga Prof. A. Xhuvani, patriot dhe demokrat i vjetër, pedagog që në themelimin e Normales në vitin 1909 dhe drejtor i saj për një kohë të gjatë. Prof. Xhuvani jo vetëm nuk e pengonte aktivitetin politik të nxënësve, po ai e inkurajonte atë. Në këtë periudhë u formuan në Shkollën Normale shoqëri «sportive», të cilat në mjaft raste u bënë mbështetje për përhapjen e lëvizjes demokratike, sidomos në nxënësit konviktore dhe e forcuan luftën që zhvillohej në radhët e normalistëve kundër regjimit tiranik të Zogut. Idetë e Revolucionit të Torrit, që kishin depërtuar dhe në vendin tonë të vogël nëpërmjet demokratëve të vërtetë si Avni Rustemi, Bajram Curri, etj., i tmerronin feudalët. Ata dridheshin nga këto ide, prandaj përpiqeshin të shuanin çdo çfaqje demokratike. Zgjedhja e Zogut si kryeministër dhe ministër i punëve të brendshme në fillim të vitit 1924, qëndrimi antipopullor dhe reaksionar gjithënjë më i hapët i qeverisë së tij, shtypja dhe mohimi i të gjitha lirive demokratike, arrestimet, internimet dhe burgosjet e ashpërsuan dhe më shumë luftën politike, demokracisë politikë tradhëtare të Qeverisë së Zogut dhe shtuan radhët e antizogistëve. Me opozitën parlamentare ishin po thuaj të gjitha krahinat dhe sidomos rinia e organizatës «Bashkimi». Avni dhe pjesa e shëndoshë e vendit e udhë-

heqnin popullin në luftën demokratike për përmbysjen e qeverisë së Zogut. Në këtë luftë muarrnë pjesë aktive dhe nxënësit e Normales, të cilët kishin formuar bindje se Shqipëria e vërtetë, e lirë, e pavarur dhe demokratike mund të bëhej në luftë me Zogun, Vërlacin dhe gjithë feudo-bor-gjezinë që përkrahte politikën antikombëtare të qeverisë që ishte në fuqi.

Në ndiqim me vëmendje të madhe ngjarjet e brendshme dhe shtypin, i cili në mjaft raste paraqiste rezikun që i kanosej Atdheut tonë të dashur. Kur Zogu kreu krimin e shëmtuar, duke vrarë Avni Rustemin, shkolla jonë zjeu si e gjithë Shqipëria, Zemrat tona djalošhare gufonin kundër kriminelëve që kërkonin të qëndronin në fuqi me krime e terror. Varrimi i Avniut dhe manifestimi i madh politik që u zhvillua me këtë rast në Vlorë, preku zemrat tona, duke ngjallur urrejtjen më të madhe kundër bishave me fytyrë njeriu, që vranë birin besnik të popullit shqiptar. N'ato ditë zie normalistët, të mbledhur grupe-grupe, flexonin fjalimet revolucionare që u mbajtën në varrin e Avniut dhe aprovonin me bindje të thellë frymën revolucionare të tyre, siç përkrahën pa rezervë edhe revolucionin e qershorit të vitit 1924. Një pjesë e shokëve tanë u bënë anëtarë t'organizatës «Bashkimi», që u formua nga fundi i qershorit dhe shumica jonë ishin simpatizantë të kësaj organizate.

Fitorja e revolucionit na shtoi entuziazmin dhe na ngjalli shpresa të reja për t'ardhmen. Ne e mbështetëm me gëzim programin e qeverisë së Fan Nolit dhe pritnim zbatimin e shpejtë të programit. Shokët tanë, që mbaruan shkollën në korrik të vitit 1924, atje ku punonin si mësues përkrahnin reformat dhe e edukonin rininë me frymën e lirisë dhe të demokracisë. Si anëtarë ose simpatizantë t'organizatës «Bashkimi», ata zhvilluan një aktivitet të gjerë në favor të qeverisë që kryesonte Fan Noli. Kur Zogu me merce-narët e tij sulmoi Shqipërinë, ata qe-

në nga vullnetarët e parë që me armë në dorë luftuan kundër-revolucionin, me gjithë gabimet e mëdha që kish bërë qeveria e Nolit, duke mos zbatuar programin revolucionar që kishë shpallur.

Për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit të qershorit normalistët e viteve të fundit që ndiqnin shkollën u vunë në dispozicion me armë në dorë, duke pasur si përgjegjës të grupit mësuesit e tyre Ahmet Duhaxhiun dhe Luigj Filën. Duke qëndruar më shumë se dy javë në qafën e Krrabës ne pritnim urdhëra për të luftuar kundër Zogut dhe forcave të tij, të armatosura në Jugosllavi dhe të ndihmuara nga vrangjelistët, që strehohehin atje. Mirëpo qeveria e Fan Nolit, e papregatitur dhe e paorganizuar, e tradhëtoi nga brenda, nuk që në gjendje t'i rezistonte kundër-revolucionit.

Pjesëmarrja e normalistëve kundër A. Zogut dhe forcave të tij tregon se ata ishin gati të përkrahnin fitoret e revolucionit demokratiko-borgjez pa kursyer dhe jetën e tyre. Puna e pedagogëve dhe e kolektivit të shkollës kish rënjosur në shpirtërat e normalistëve dashurinë për popullin, për lirinë demokratike dhe u kish ngjallur urrejtjen kundër feudo-borgjezisë e gjithë forcave reaksionare që qenë nësuar ta çfrytëzonin Shqipërinë si çiflikun e tyre.

Me t'u kthyer, Zogu mori masa të shpejta për të shtypur kundërshtarët e vet: arrestime, internime dhe pushime nga puna u bënë anë e mbanë Shqipërisë që në fillim të vitit 1925. Kështu u pushuan nga puna Ahmet Duhaxhiu dhe Luigj Filaj dhe u internuan, u pushuan nga detyra e mësues-

sisë maturantët normalistë të vitit 1924, si Eqrem Çanua, Irfan Roshj e Thanas Konomi, që muarnë pjesë me armë në dorë kundër A. Zogut dhe forcave të tij.

Për t'u hakmarrur kundër normalistëve Zogu dërgoi në Elbasan gjeneral Gjilardin, i cili me fjalët më të ndyra u përpoq të ulte dhe të poshtëronte gjestin patriotik të nxënësve të Normales. Për të diskredituar Shkollën Normale dhe kolektivin e saj qenë dërguar shpesh bashibozukët e Hysni Demës, të cilët futeshin në klasa, në konvikte dhe kudo pa leje dhe në mënyrën më brutale. Po shpesh këta mercenarë hasën në rezistencën e nxënësve normalistë dhe sidomos të profesor Andon Dedës, i cili ishte dhe drejtor i konviktit.


Me gjithë burgosjet, internimet, pushimet nga puna dhe terrorin, me gjithë kanosjet që u bëheshin nxënësve të Normales për përjashtimin e tyre nga shkolla dhe prerjen e bursës, ata e vazhduan luftën pa ndërprerje në formë të ndryshme për përmbysjen e feudo-borgjezisë dhe triumfin e revolucionit popullor.

Ata ecën të patrembur në traditat patriotike të shkollës, duke dhënë një kontribut të çmuar në revolucionin e vitit 1924 dhe në lëvizjen demokratike të vendit, gjë që u duk më mirë gjatë luftës nacional-çlirimtare, kur normalistët, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste Shqipëtare mbushën radhët e çetave, bataljoneve dhe brigadave sulmuese.

SIRI SHAPLLO
Ish-nxënës i vitit 1926



Trupi mësimor dhe maturantët e vitit 1936



Kori i Shkollës Pedagogjike më 1957

RRUGA E SHKOLLËS NORMALE

Në rrugën e shkëlqyeshme të Normales së vjetër

Shkolla jonë pedagogjike ecën përpara, drejt suksesesh të reja

Shkolla Normale e Elbasanit, sot Shkolla Pedagogjike «10 Korrik», ka përshtetur një rrugë të lavdishme. Ajo u hap për herë të parë në dhjetor 1909, kur Atdheu ynë rënkonte nën tiraninë e turqve. Kjo e drejtë nuk u dha me mirëdashje nga ana e turqve, por u shkëput me luftë, gjak dhe sakrificë.

Hapjen e shkollës e vendosi Kongresi, që u mbledh në Elbasan prej datës 20-25 gusht 1909.

Hapja e së parës shkollë për mësues u prit me entuziazëm nga mbarë populli shqiptar, prandaj as ndjekiet e Shefqet Durgut Pashës, as ndërhyrjet e palëve ndërluftuese në luftën ballkanike, as ngatërresat e austro-hungarezëve nuk mundën ta shlyejnë punën e saj, pse nuk ishte e mundur të mposhtësh dëshira e popullit tonë për liri dhe arësim. Prandaj dhe Normalja i qëndroi rrebeshit me trimni.

Gjatë kësaj kohe Normalja u ba një qendër e randësishme arësimore e kulture. Nga gjini i saj kanë dalë vazhdimisht çdo vit 30-50 maturantë, të pajisun me dijenit' e nevojëshme për t'ushtruar profesionin e pedagogut. Ndonse ka punue në një kohë kur arësimi dhe kultura ishin në dorën e klasës feudalo-borgjeze, që i drejtonin në dobi të saj, prapë se prapë Normalja ka krye një shërbim të madh. Ajo ka ndihmue për përhapjen e arësimit dhe të kulturës në masat e gjana të popullit. Bijt e saj, që në pjesën ma të madhe ishin prej shtresave të mesme dhe të vorfëna, kanë punue me vullnet edhe në vendet ma të largëta, të veçueme nga bota, pa përkrahjen e kujt dhe nën vëzhgimin e xhandarit analfabet. Ata e njoftën mirë jetën e popullit, hallet dhe vuezjtjet e tij, prandaj, kur u erdhi ndorësh, u munduen me ja hapun atij sytë për ta kuptue të vërtetën.

NORMALJA — QENDËR E PERHAPJES SË METODAVE TË REJA PEDAGOGJIKE

Metoda herbartjane, që ishte përparimtare në atë kohë, kur pjesa ma e madhe e mësuesve ndiqnin metoda mesjetare, u përhap me anën e ushtrimore. Mandej kjo u zavëndësue me metodat e reja, që u sollën nga normalistët që studjuan në Institutin «Zhan-Zhak Ruso». Mbi të gjitha Normalja u ba një vatër e randësishme për mësimin e gjuhës shqipe. Nga kjo shkollë kanë dalë nxanës të talentuem, të cilët kanë punue për t'u mësue brezave të rij një shqipe të kullueme. N'asht se Normalja ka punue mirë në atë periudhë, kjo i detyrohet punës së pa-

lodhur të drejtorit të atëherëshëm Luigj Gurakuqit dhe ma vonë Aleksandër Xhuvanit si dhe të mësuesve të tjerë Simon Shuteriqit, Sali Çekës, Dhimitër Paparistos, Peter Dodbibës, Zef Kolombit, etj., që i kanë vue të gjitha forcat që puna e shkollës të shkonte sa ma mirë. Na përulemi sot me nderim përpara punës së këtyne veteranëve t'arësimit.

Edhe zhvillimi kulturalo-artistik shkoi tue përparue prej viteve 1931-1938. Qenë normalistët të parët ata që në vitin 1929 nxorrën organin e tyre «Normalisti», të cilin e mbajtën gati për 8 vjet rrjesht, tue kursye edhe kafshatën e gojës. Kjo revistë e përmuejshme nxiste talentet e reja. Aty e provuan pendën Qukapiku, Sterjo Spaseja, Sotir Caci, etj. Revista krijoi lidhje të shëndosha ndërmjet nxanësve të vjetër dhe shkollën e ndihmoi sado-pak në punën e arësimit në përgjithësi.

Puna artistike qëndronte mjaft nalt. Gjatë viteve 1931-1936 çdo klasë ka pasë grupin teatral, që jepnin çfaqje për shkollën dhe për publikun. Orkestra e shkollës ishte ma e mira e qytetit. Gjatë viteve 1930-1936 jepeshin mesatarisht nga 3-4 çfaqje nga nxanësit e shkollës. Nga çfaqjet që kanë pasë ma sukses kanë qenë «Karl Topia», «Skënderbeu», «Besa», «Fe dhe kombësi», «Fejesa me pahirë», «Lulja», «Fshatari zotni», etj. Disa nga këto çfaqje u dhanë edhe ndër qytetet e tjera të Shqipnisë. Me 10 dhjetor 1930 u themelue shoqnia «Normalisti shëtitës 32», që kishte për qëllim të mbliidhte fonde për të krye shëtitjen rreth Shqipnisë; kjo u fillue nga maturantët e vitit 1932 dhe u ndoq nga ata të 1933 dhe 1934. Nga shoqnit e fundit meriton të përmendet S.N.F. (1939), e cila kishte si program të sillte eshtrat e Naim Frashërit n'Atdhe dhe të botonte të gjitha veprat e tij.

N'anë tjetër edhe aktiviteti sportiv ka qenë i theksuem. Më 1930 Normalja filloi festivalin e atletikës, që u përsërit çdo vit. Skuadrat e futbollit, volejbollit dhe basket-bollit të shkollës ishin në gjendje me u bamë ballë skuadrave të qytetit dhe shpesh herë i kanë këputë fitime edhe Gjimnazit të Tiranës, Shkollës Teknike dhe Tregëtares së Vlonës.

NORMALISTËT KUNDËR REGJIMIT TË ZOGUT DHE FASHIZMIT

Në saje të këtij aktiviteti Normalja i hyri në zemër popullit t'Elbasanit, që e quante me emërin «Shkolla jonë». Kur më 1938 klika sunduese deshi me e shpërngulë në Shkodër, mbarë populli u ngrit dhe e ndaloi. Por mënyra e organizimit në shkollë nuk u pëlqente aspak Musa Jukës me shokë, që donin me zhdukë çdo inisiativë dhe ta bënin rininë vegël të tyre. Prandaj me urdhën të Ministrisë s'Arësimit më 1938 shoqënitë ndër shkolla u shpërndanë dhe «Normalisti» u mbyll. Ky veprim e shtoi edhe ma tepër urrejtjen e normalistëve kundër regjimit të Zogut.

Në të vërtetë ata nuk kishin qenë kurrë me këtë regjim: që më 1924, të organizuëm në shoqninë «Bashkimi», ata e kundërshtuen kthimin e Zogut në Shqipni. Qeveria nuk i kishte shikue me sy të mirë nxanësit e shkollës, por kohët e fundit gjindarmëria filloi ta vëzhgonte ma tepër punën e shkollës. Kështu në qershor të vitit 1938 u arrestuen shumë nxanës të shkollës, si Sami Baholli, Sav Kavaja; ma vonë ata u internuen. Edhe në procesin që u zhvillue në Tiranë kundër grupit komunist, të kryesuem nga Qemal Stafa, kishte mjaft normalistë, ndër të cilët edhe dëshmori Abdyl Myzyri, që ma vonë u lirue për moshë të

vogël. Në ditët e zeza të Prillit 1939 normalistët e treguen se sa fort e donin Atdheun. Normalja që shpirti i demonstratave që u zhvilluen në Elbasan. Si një bllok i vetëm normalistët u ngritën për të kërkuar armë dhe për të luftuar anmikun. Por Zogu, që na kishte shitë me kohë tek i hueji, tue pasë frikë nga populli i vet, urdhënonte gjindarmërinë që të bante çmos për të eliminuar nxanësit e shkollës që ta kishte rrugën e lirë. Kështu me gënjeshtër, 80 e ca normalistë u mbyllën në kamazmat e Krastës.

Mbas pushtimit të vendit fashistët u munduen ta shtinin në dorë edhe Normalen, sikurse gjithë shkollat e tjera. Ata sollën drejtor dhe profesorë italianë, futën doktrinën e fashizmit dhe përdorën korrupsionin. Por Normalja qëndroi nëalt. Në ditët e para filloi rezistencë pasive: nxanësit nuk përgatiteshin, banin mungesa të shumta, goditnin profesorët reaksionarë dhe të huej. Më 1941, kur Gjermania naziste sulmoi Bashkimin Sovjetik dhe mbas formimit të Partisë Komuniste Shqiptare, rezistenca filloi t'organizohet. Aktiviteti klandestin u shtue shumë gjatë muajve të parë të 1943-së. Rinia e shkollës ishte kudo në ballë dhe populli i Elbasanit i mban mend mirë bijt e tij, që shpërndanin trakte, kërkonin ndihma dhe e sqaronin atë. Kjo rezistencë u kundërshtoi ditën e 1 Majit 1943, kur, me thirrjen e Partisë Komuniste, gati 100 nxanës lanë bankat e shkollës dhe rrokën armët. Ata e kishin kuptue se atëhere detyra kryesore e çdo atdhetari ishte çlirimi i Atdheut.

Ditët e fundit të vitit shkollor entuziazmi për luftën arriti kulmin. Fashistët ua kishin frikën nxënësve, prandaj me telegramin shifër Nr. 5102, datë 22/5/1943 Ministria e Arësimit urdhënoi premjen e mësimeve dhe shpërndamjen e nxanësve. Por menjëherë nxanësit grumbullohen në oborr dhe nga mesi i tyre del një ilegal, që u flet shokëve për detyrat që i presin gjatë verës. Gjatë pushimeve nxanësit vazhduan punën e tyre dhe shumica morën pjesë në luftën për liri. Të njajtën rrugë ndoqën edhe pjesa dërmuese e mësuesve që dolën nga kjo shkollë: të rrjedhën nga shtesa të vorfëna dhe të mesme, ata nuk mund të qëndronin larg luftës së popullit, prandaj morën pjesë aktive në të, tue i bashkuar atdheut edhe jetën e tyre në lulen e rinisë. Normalja krenohet me 45 dëshmorët e saj, në krye të cilëve qëndron patrioti i çquem Avni Rustemi.

NORMALJA NË RRUGËN E SHKOLLËS POPULLORE

Në sajë të luftës nacional-çlirimtare populli ynë i dëboi anmiqtë dhe fitoi lirinë. Menjëherë pushteti popullor u interesua për arësimin dhe u hapën shkollat. Ndër të parat që dhe shkolla jonë, që i filloi mësimet qysh në muajin frur të vitit 1945. Pengesat ishin të shumta, por s'ka pengesa që nuk i kapërxe hovi revolucionar i rinisë, t'udhëhequr nga Partia jonë.

Me reformën arësimore të vitit 1946 u përmbysën tekstet dhe programet e vjetra dhe u zavendësuen me ato të shkollës sovjetike.

Me këtë mësimi u mbështet në bazat e shëndosha të teorisë marksist-leniniste. Detyra të rëndësishme viheshin përpara shkollës sonë: ajo duhet t'i pajiste nxanësit me njohuri të shëndosha shkencore dhe të shkolliste tek ata vetitë e moralit komunist. Na mund të themi me bindje se shkolla jonë i ka plotësue me nder këto detyra. Ajo po vazhdon me bes-

nikëri traditat e lavdishme të Normales së vjetër dhe po i çon ato përpara në konditat e reja.

Pas vitit 1945 e deri më sot nga bankat e saj kanë dalë 1131 mësues, domethanë ma tepër se gjatë periudhës 1909-1944. Shumica e nxanësve që kanë mbarue këtë shkollë kanë qenë kursistë t'ardhun nga të katër anët e Atdheut. Kjo shifër tregon kujdesin e madh të pushtetit popullor për përgatitjen e kuadrove arësimore në vendin tonë. Duhet theksue se para çlirimit kishte vetëm dy shkolla normale — Normalja e Elbasanit dhe Instituti Femnor i Tiranës, kurse sot kemi 8 të tilla.

PUNA PËR FORMIMIN E PËRGJITHËSHËM TË NXANËSVET

Në shkollën tonë i kushtohet një kujdes i veçantë formimit të përgjithëshëm të nxanësve dhe përgatitjes së tyre profesionale.

Një vëmendje të posaçme na i kemi kushtue përgatitjes së nxanësve në gjuhë e letërsi, që është një landë e dorës së parë, sidomos për shkollën pedagogjike. Në këtë drejtim shkolla jonë ka tradita të mira. Gjurma të thella ka lanë këtu puna e lavruetit të palodhun të shqipes. Profesor Aleksandër Xhuvanit dhe e profesorëve Simon Shuteriqi dhe Fot Papajani. Na, nxanësit e tyre, po mundohemi t'ecim në gjurmat e mësuesve tanë. Tue fillue prej vitit 1955, kur kjo landë u muer në shqyrtim nga Këshilli i Përgjithëshëm Arësimit, na kemi ndjekë punën tue e ba mësimin e gjuhës problem të drejtorisë, të personelit mësimit dhe të vetë nxanësve. Çdo vit na e analizojmë në këshillin pedagogjik gjendjen e kësaj lande dhe konstatojmë se ka mjaft përmirësime.

Provimet e klasave dhe ato të Shtetit të këtij viti shkollor na japin shpresa se në t'ardhmen puna do të shkojë ma mbarë në këtë landë.

Veç përgatitjes së përgjithëshme, na i kushtojmë kujdes edhe zhvillimit të talenteve të reja. Që prej vitit 1946 funksjonon në shkollë rrethi letrar i të rinjve. Ky rreth organizon punën letrare në shkollë me anën e mbrëmjeve letrare, recensioneve, etj. Aktiviteti i tij shtrihet përtej mureve të shkollës, në qendra pune e prodhimi dhe në repartet ushtarake. Rrethi ka organin e vet «Letrari i Ri», ku provojnë pen-dën talentet e reja, si Musa Vyshka, Viktor Qurku, etj.

Mirë shkon edhe përgatitja profesionale e nxanësve. Këtu na jemi ma mirë një gradë ma nalt se Normalja e vjetër, jo vetëm se pedagogjia dhe psikologjia që mësohen sot janë të mbështetuna në shkencën marksiste-leniniste, por edhe pse një kujdes i madh i vihet lidhjes së teorisë me praktikën. Puna e mësimit të metodikave ka ndryshue kryekëput. Ndërsa përpara zhvillohej një kurs i shkurtën dhe skematik, tani zhvillohet kursi i plotë i metodikës së shkrim-këndimit, së grammatikës, s'arithmetikës, historisë, gjeografisë, mësimit të natyrës, vizatimit, bukurshkrimit, fiskulturës. Kështu nxanësi ka një bazë të shëndoshë për dhanien e mësimit dhe nuk ka nevojë të mbështetet në receta të gatëshme.

Një ndryshim rranjësor asht ba edhe në dhanien e këtyre disiplinave: ndërsa përpara ato jepeshin nga mësuesi i praktikës ose nga mësuesit e ushtrimores, tashiti i zhvillojnë mësuesit e landëve përkatëse, të cilët, tue pasë një përgatitje ma të thellë teorike, mund të mënjanojnë skematizmin dhe praktikizmin e ngushtë. Për të mënjane të metën tjetër, atë të spjegimit teorik dhe formal, në shkollën tonë

asht ba një punë e mirë, tue i udhëzue dhe ndihmue metodistet me kohë. Spjegimi i metodikave lidhet ngushtë me programin dhe me tekstin e shkollës fillore. Kështu nxanësit, tue mësue landën, njohin edhe punën e shkollës fillore. Nga kjo formë pune metodistet janë të detyruem të ndjekin me vemendje punën që bahet n'ushtrimore, si mësimet shëmbëllore, analizat, bile të japin edhe vetë mësim në shkollën fillore. Tue veprue kështu nuk ngrihet vetëm cilësia e punës që ata bajnë në metodike, por edhe në landën përkatëse. Sistemi i praktikës pedagogjike asht dhe ma i plotë: ndërsa përpara puna kufizohej me hospitimin dhe 5-6 prova praktike, tani nxanësit e fillojnë praktikën pasive me temat e klasës së dytë, e vazhdojnë me atë të klasës së tretë dhe me mësimet shembëllore të metodikave dhe e mbyllin me temën «Ditët e para të fëmijëve në shkollë», që zhvillohet në klasën e katërtë në javën e parë të vitit shkollor. Në praktikën aktive nxënësit janë të detyruem të japin 9 prova praktike, tue mos llogaritë punën jashtë klasës dhe me pionierët; veç kësaj zhvillohet edhe praktika një-ditore dhe ajo e vijueshme tri-javore në shkollat e qytetit dhe të fshatit.

Tue fillue prej vitit të kaluem na i kemi vue randësi të madhe organizimit të praktikës me klasa kolektive në shkollat e fshatit. Për këtë nxanësit janë nda në grupe prej 5-6 vetësh me në krye një pedagog, që asht përgjegjës për punën që bahet gjatë gjithë javës. Gjatë kësaj punë nxanësit vezhgojnë punën e mësuesit e të shokëve dhe japin 2-3 ditë mësim.

Mirë organizohet dhe ndihma për kandidatët. Për këtë para zhvillimit të mësimit jepen udhëzime dhe koregjoen konspektet. Para zhvillimit të praktikës së vijueshme tri-javore si edhe para provimit përfundimtar të praktikës pedagogjike, organizohen konsultime 5-6 ditore nga mësuesit e ushtrimore, metodistët dhe udhëheqësit e praktikës.

Pranë shkollës pedagogjike punon edhe shkolla ushtrimore me 3 paralele dhe 240 nxanës. Me ndihmën e mësuesve t'ushtrimore nxanësit e pedagogjikes kanë mundësi ta zhvillojnë mirë praktikën pedagogjike. Personeli i shkollës ushtrimore në pjesën dërmuese ka vue të gjitha forcat për t'u ardhë në ndihmë mësuesve t'ardhëshëm. Edhe kabineti pedagogjik i shkollës zhvillon një punë të mirë në këtë drejtim; atje nxanësit nuk gjejnë vetëm literaturën që u nevojitet, por edhe modelet e mjeteve mësimore për çdo mësim që kanë për të zhvillue. Na jemi të sigurtë se me punën që bahet në këtë drejtim, mësuesit e ardhëshëm kanë mundësi t'orientohen në praktikë; ata nuk kanë nevojë ta gjejnë me të qëllueme rrugën, pse këtë ua ka mësue shkolla; tue u mbështetë në dijenitë që marrin ata kanë mundësi ta çojnë edhe më përpara punën.

LIDHJA E TEORISË ME PRAKTIKËN

Pregatitja në landët e matematikës, fizikës dhe biologjisë e të kimit asht ma e plotë.

Në matematikë nxanësit marrin njohuritë kryesore rreth algjebres, gjeometrisë plane dhe stereometrisë. Veç këtyre mësohet edhe aritmetika racionale, që ndihmon mjaft në profesionin e mësuesisë. Në këto landë nuk i vihet randësi vetëm spjegimit teorik, por edhe lidhjes së teorisë me praktikën, tue bamë punë praktike, si matje në terren, etj.

Po këtu i vihet kujdes edhe lidhjes së spjegimit të mësimit me punën që do të bahet në fillore. Në fizikë dhe shkencë biologjike nxanësit mësojnë të zbatojnë në praktikë njohurit e tyre; veç kësaj, ata familjarizohen me aparatet dhe eksperimentet që do të nevojiten edhe në shkollën fillore. Këtu na jep dorë shumë edhe pajisja e shkollës me laboratorët e fizikës, të kimisë dhe të shkencave biologjike; ky i fundit asht pajisun ma së miri me të gjitha mjetet për të zhvillue një punë shembullore.

Një kujdes i veçantë i vihet lidhjes së spjegimit me punën në prodhim. Nën udhëheqien e mësuesve, nxanësit kanë vizitue qendra pune dhe prodhimi, si fabrikën e konservimit të frutave, atë të vaj-sapunit, Kombinatin e Drunit «Nako Spiru», repartin e zdrukthëtarisë të N.I.L. Prodhimeve të ndryshme, rafinerinë e naftës, T.E.C.-in e Cerrikut, etj. Edhe në mësimin e bujqësisë, me gjithë mungesën e specialistëve, bahet një punë e kënaqëshme. Shkolla ka një kopsht prej 1 hektar, ku nxanësit nuk bajnë vetëm vërejtjet e nevojëshme, por kryejnë të gjitha punimet, që prej përgatitjes së tokës deri në vjeljen e produkteve. Veç kësaj, ata kanë vizitue fidanishten pyjore, fermën «Syrja Dylgjeri», etj. Shumë ndihmon edhe kandi i gjallë me kafshë dhe me shpendë, për të cilët kujdesen vetë nxanësit.

Djathhtësitë janë vue në rrugë të drejtë. Ndërsa përpara programi i vizatimit përfshinte ma tepër vizatime të kopjume simbas modeleve të gatëshme, tani nxanësit stërviten në të gjitha format si vizatim nga natyra, vizatim dekorativ, etj. Mirë organizohet edhe stërvitja e nxanësve në dërrasën e zezë. Shumë e ka ndihmue punën ngritja e sallës së vizatimit, që asht pajisë me tryezat dhe mjetet e nevojëshme për zhvillimin e mësimit.

Në punën e ditës na kemi ba një hap të madh përpara. Ndërsa ma parë zhvillohej një punë e thjeshtë me letër e karton, këto dy vjetët e fundit asht zhvillue programi i plotë, që përmbledh punën me letër, me karton, me dru, me metal, me baltë e allçi. Vitin e kaluem janë ba punë të bukura me karton — si mjetet e transportit (aeroplani, avullorja, helikopteri, automobili, karoca), mullini me erë dhe ujë, si edhe 60 koleksione. Këtë vit janë përgatitë një mori figurash gjeometrike nga nxanësit e klasës së parë, punime me dru nga ata të klasës së dytë (si tezgjahe për lidhjen e librave, koshere bletësh, kotecë për mbajtjen e lepujve); nxanësit e klasës së tretë kanë përgatitë koleksione shumë të mira, pjesë arithmetike — si numuratore, kuti arithmetike, aparate për zhvillimin e katër veprimeve; klasa e katërtë ka përgatitë modelin e furrës së naltë, harta gjeografike, maketin e qytetit të Tiranës, etj. Këto punime nuk i ndihmojnë nxanësit vetëm për profesionin e ardhëshëm, por edhe u kalitin qëndrueshmërinë, durimin, dhe, mbi të gjitha, dëshirën për punë. Këtu na ka ndihmue shumë laboratorin e punës së dorës, që asht i pajisun me të gjitha mjetet e nevojëshme; ky na asht dhurue nga Kombinati i Drunit «Nako Spiru» që e ka në kujdestari shkollën tonë.

Në mësimin e muzikës dhe të veglës muzikore shkolla ende nuk ka mbrijtë aty ku duhet të jetë. Por këtë vit na e kemi vue në rrugë punën, tue sigurue 85 violina të reja. Me punën që asht ba gjatë kësaj kohe, u ba e mundun që kandidatët ta japin mësimin e këngës tue e shoqne me vegël. Për të parën herë u krijue dhe orkestra e

shkollës, në të cilën marrin pjesë 22 vetë. Vitin që vjen na mendojmë të fusim si vegël muzikore edhe mandolinën.

Përpara ka shkue përgatitja fiskulturale e nxanësve. Në këtë drejtim nuk jemi mundue vetëm të përgatisim njerëz me trup të shëndoshë, por edhe mësues të mirë, që të dijnë me e zhvillue këtë landë në shkollën fillcre. Prandaj asht punue që nxanësit të zotnojnë komandën, fazat e orës së mësimit, etj. Shkolla i ka të gjitha mjetet për zhvillimin e fiskulturës: ajo ka një palestër të vogël, por të mjaftueshme për zhvillimin e mësimit, pajisun me të gjitha veglat e nevojëshme; një kand sportiv të ndërtuem nga vetë nxanësit dhe që përmbledh fushën e futbollit, dy fusha volej-bolli dhe një basket-bolli. Aktivitetin fiskultural e ndjek më vemendje gjithë kolektivi. Shumë mirë asht zhvillue spartakiada e këtij viti, që ka vu në lëvizje gjithë nxanësit; veç këtyre shkolla ka një skuadër të mirë futbollit, skuadrat e volejbollit dhe të basket-bollit për djem e vajza, gjimnastikantët, etj.

Tue fillue prej vitit shkollor 1954-1955, pranë shkollës pedagogjike funksionon edhe shkolla 2-vjeçare e kualifikimit të arësimitarëve, që ka një program të njajhtë me atë të pedagogjikes. Nxanësit, që ndjekin këtë shkollë, janë mësues me eksperiencë të gjatë, të cilët nuk kanë pasë mundë të marrin arësimin përkatës. Shumica e tyre bajnë përpjekje të shumta dhe dalin me përfundime shumë të mira. Tue fillue prej vitit kaluem nga kjo shkollë dolën maturantët e parë, të cilët si edhe këta të këtij viti janë tregue në nivelin e duhun dhe kanë pasë në përgjithësi përfundime shumë të mira.

PUNA JASHTËSHKOLLORE DHE AJO E DOBISHME SHOQËRORE

Aktiviteti jashtë klase dhe jashtë shkolle ka marrë një hov të madh. Që prej vitit 1946 shkolla ka pasë vazhdimisht dy grupe teatrale (atë të shqipës dhe të gjuhës ruse), që kanë dhanë çfaqje për nxanësit, prindërit dhe për qendrat e punës e të prodhimit. Veç kësaj shkollla ka grupin e recituesve, të solistëve, korin, orkestrën, grupin e akrobatëve dhe baletin, të cilët kanë korrun sukses në të gjitha çfaqjet.

Tue fillue prej vitit 1949 ka fillue kremtimi i festës tradicionale të shkollës, që asht ba ditë takimi të përzemërt ndërmjet nxanësve të vjetër dhe të rij. Në mënyrë madhështore janë kremtue 40-vjetori dhe 45-vjetori i themelimit të shkollës, që do të mbesin të paharrueme në kujtimin e gjithë pjesëmarrësve. Tue fillue nga viti 1953 çdo vit asht kremtue mbramja tradicionale shqiptaro-sovjetike e bashkë me të edhe rinia jonë ushqejnë për mikun tonë të madh, Bashkimin e lavdishëm Sovjetik. Në këto mbrëmje janë organizue çfaqje me pjesëmarrjen e grupeve teatrale, të korit, orkestrës, recituesve, baletit dhe t'akrobatëve. Këto festa janë organizue çdo vit e ma mirë, por meritojnë të përmenden ato të viteve 1953, 1955, 1957 e 1958, që janë pëlqve nga publiku; shkolla asht çmue dhe shpërblye nga Shoqëria e Miqësisë Shqiptari-B.R.S.S. për përgatitje të mira të mbrëmjeve shqiptaro-sovjetike.

Puna për dëfrimin dhe edukimin e nxanësve asht organizue mirë gjatë çdo viti. Mjafton të përmendim se vetëm gjatë vitit shkollor 1958-59 janë organizue mbrëmje tematike, siç janë ajo për 50-vjetorin e ditëlindjes së shokut Enver Hoxha, për 40-vjetorin e themelimit të Komso-

molit, për 17-vjetorin e themelimit të Rinisë Komuniste Shqiptare, mbra-
mja e miqësisë me Azerbaixhanin, festa e 49-vjetorit të themelimit të
shkollës, festa e vitit të ri, mbramje për nder të nxanësve të dalluem,
mbramje tradicionale shqiptaro-sovjetike për vitin 1959, etj. këto akti-
vitete janë ndjekë me kënaqësi të madhe nga gjithë kolektivi dhe të
ftuemit.

Tue fillue nga ky vit shkollor na po e përtërijmë traditën e vjetër
që kishte Normalja: në mbarim të shkollës nxanësit vizitonin vendet
kryesore t'Atdheut. Këtë vit me një numur të madh nxanësish (rreth
100 vetë) u vizitue Hidrocentrali «Karl Marks», qyteti i Shkodrës, Apo-
llonia dhe Vlona. 130 nxanës të shkollës së kualifikimit vizituen Beratit,
Apolloninë dhe Vlonën. Këto ekskursione janë krye vetëm me mjetet e
nxanësve dhe të personelit mësimor. Kështu ka mundësi që brënda 4 vje-
tëve nxanësit të vizitojnë qytetet kryesore t'Atdheut.

Ma mirë është organizue puna e dobishme shoqënore. Tue fillue
prej vitit 1946 nxanësit kanë marrë pjesë në shumë aksjone nacionale
dhe lokale. Në hekurudhën Durrës-Peqin mori pjesë një brigadë me
rreth 200 vetë. Brigada u shpall sulmuese dhe u dekoruen mbi 30 vetë.
Në hekurudhën Durrës-Tiranë morën pjesë 120 të rinj, në atë Peqin-
Elbasan 130 të rinj; brigada u shpall tri herë sulmuese dhe u dekoruen
rreth 40 vetë; në hidrocentralin «Karl Marks» morën pjesë 80 të rinj.
Po kështu nxanësit e shkollës kanë punue në hekurudhën Elbasan-Krastë,
në Cërrik e në Fermën «Syrja Dylgjeri». Gjatë vjetëve shkollorë
nxanësit kanë dhanë një kontribut të madh tue punue për ndërtimin e
kombinatit të drurit «Nako Spiru», për sistemin e përroit të Manazde-
res, për pyllëzimin e qytetit, për mbledhjen e pambukut dhe t'ullinjve.
Kjo punë mund të llogaritet në disa qindra mijë orë, tue i kursye shte-
tit disa milionë lekë. Mjafton të përmendim se gjatë vitit shkollor 1958-
1959 nxanësit dhe personeli i shkollës kanë krye një vëllim pune, që
vlerësohet në ma shumë se 500 mijë lekë; ata kanë rregullue kampion
sportiv, që përmbledh fushën e futbollit, dy fusha volejboli dhe një
basket-boli, lulishten e shkollës, 300 metra kanal për sjelljen e ujit të
pijshëm dhe kanalizimin e oborrit të mbrëndëshëm. Veç kësaj këtë vit
nxanësit dhanë fjalën të punojnë një muej tue qenë në dispozicion t'orga-
nizatës së rinisë, por meqë nuk u sigurue fronti i punës, një pjesë pu-
nuen në brigadat kulturele në fshat, kurse pjesa tjetër ndihmoi për zbu-
kurimin e shkollës.

Për herë të parë këtë vit u organizue edhe vetë-shërbimi në shko-
llë e në konvikt. Veç dobisë materiale, nga kjo punë nxanësit kanë fitue
shkathhtësi e durim dhe u asht shtue dashunia për punë.

Për edukimin dhe mobilizimin e nxanësve një punë të madhe ka
ba organizata e rinisë së shkollës. E udhëhequn nga organizata e Partisë
dhe e ndihmueme nga drejtoria e gjithë personeli mësimor, ajo asht ba
krahu ynë i djathtë. Kështu të rinjt' e shkollës sonë po ndjekin traditat
e lavdishme të rinisë së Shkollës Normale, që gjatë luftës nacional-
çlirimtare e kreu me nder detyrën e saj tue dhanë një kontribut
madh në luftën për liri.

NORMALJA E KA KRYE E DO TA KRYEJË ME NDER MISJONIN

Mbi të gjitha ne krenohemi se pjesa dërmuese e 2.120 nxanësve që kanë mbarue këtë shkollë, si edhe pjesa dërmuese e personelit mësues, janë dallue për një punë të mirë në dobi t'Atdheut. Na krenohemi se në gjinin e shkollës sonë kemi pasë arësimitarë patriotë, si Luigi Gurakuqin, Aleksandër Xhuvanin, Kostaq Cipon, Simon Shuteriqin, etj. Nga nxanësit kanë dalë njerëz revolucionarë, si Avni Rustemi, 45 dëshmorë të luftës Nacional-çlirimtare, mësues të palodhun si Qamil Guranjaku, Ndreç Ndue Gjoka, etj. Edhe sot nxanësit normalistë dallohen për një punë të ndërgjegjshme: nga radhët e tyre tani kemi dy ministra, 5 anëtarë dhe kandidatë të Komitetit Qëndror të Partisë së Punës së Shqipërisë, 5 sekretarë të parë Komitetesh Partie në rrethe, shumë funksionarë partie në qendër, disa oficerë madhorë. Nxanësit e shkollës sonë mbajnë sidomos flamurin në sektorin e arësimit. Nga gjini i tyre kemi një zëvendësiministër t'Arësimit e Kulturës, disa nëpunës së Arësimit e Kulturës, shefa seksionesh arësimi e kulture, 25 inspektorë, 7 drejtorë shkollash të mesme, 64 drejtorë dhe nëndrejtorë shkollash 7-vjeçare. Mbi 250 arësimitarë janë dekorue me urdhna dhe medalje pune për punë të mirë në arësim, 4 vetë mbajnë titullin e naltë «Mësonjës i Popullit» dhe 8 të tjerë «Mësonjës i Merituar».


Në krejt punën tonë mbas çlirimit na jemi orientue nga eksperiencia e shkollës sovjetike, që na ka primë në rrugën e vështirë t'edukimit të brezit të ri. Këtë eksperiencë e kemi marrë nëpërmjet programeve dhe teksteve, nga revista dhe gazetata, nga korespondenca me miqtë sovjetikë. Na kemi pasë fatin që për disa vjet me radhë të kemi pasë midis nesh pedagogë sovjetikë me eksperiencë, si Antonina Vasiljev-nën, Natalia Morozovën, Maja Panormovën, Ninel Çernajevën, të cilët na kanë ndihmue shumë në punën tonë. Ne do t'ju jemi atyne gjithmonë mirënjofhtës. Sot shkolla jonë vazhdon korespondencën me pedagogët e Shkollës Pedagogjike Nr. 2 të Moskës, dhe mundohet të përfitojë sa ma shumë nga eksperiencia e tyre shumë-vjeçare.

Por n'asht se sot na jemi në gjëndie të ndjekim dhe të çojmë përpara traditat e shkëlqyeshme të shkollës sonë, kjo i dedikohet udhëheqjes së ndritun të Partisë sonë të Punës, e cila e udhëheq me dorë të sigurtë popullin tonë drejt socializmit.

Prandaj, në këto ditë, kur ne po përgatitemi të festojmë 50-vjetorin e themelimit të shkollës sonë, që kremtohet në kuadrin e 15-vjetorit të çlirimit t'Atdheut, gjithë kolektivi shkollës, tue përfshi këtu edhe nxanësit e vietër e të rinitë, japin fjalën se jo vetëm do ta çojnë përpara punën e shkollës, por edhe kudo që të jenë do të punojnë për të mirën e popullit e t'Atdheut.

VASIU KAMAMI

**Drejtor i Shkollës Pedagogjike «10 Korrik»
t'Elbasanit**



Maurantët e vitit 1950



Maurantja jep provim para komisionit duke bërë një mësim të hapët në Ushtrimore

Puna që ka ba Normalja e Elbasanit për ndjekjen e zhvillimit të metodave mësimore

Gjatë 50 vjetëve Normalja e Elbasanit me anën e mësuesve që ka nxjerrë ka përhapë metoda të ndryshme mësimore, që nga metodat herbartiane deri te ato të shkollës sovjetike, që janë metodat ma të përparueme të kohës së sotme.

Që nga themelimi i saj deri më 1923 praktika pedagogjike nuk zhvillohej në një formë t'organizueme ndër nxanësit e Normales, por kohë më kohë këta dërgoheshin në klasat e disa mësuesve të shkollave t'Elbasanit për të pa zhvillimin e disa mësimëve.

Dihet se në Shqipni deri në vitet 1924-25 ndër shkolla zbatoheshin metoda të ndryshme, shumica e të cilave ishin mesjetare, përveç disa mësuesve aty-këtu, që kishin studjue në Greqi e Turqi a në ndonjë shtet të perëndimit, që përdornin ndonjë metodë a ecuni që kishin pa në vendin ku kishin studjue; e këta ishin shumë të paktrë. Shumica e mësuesve mësonin si u a merrte mendja, pa asnjë bazë e kriter, pa asnjë udhëzim. Midis këtij kaosi në punë të metodave mësimore duhej një orientim, një udhërrëfyes, një shëmbull në punën metodike e këtë e bani Normalja e Elbasanit. Me themelimin e ushtrimorese në vitin shkollor 1923-24, si nxanësit e Normales ashtu edhe mësuesit e qytetit t'Elbasanit filluen të shikonin e ma vonë të zbatonin metoda, që për atë kohë e për vendin tonë ishin përparimtarë. Këto ishin metodat herbartiane, të futuna në vendin tonë nga mësuesit e ushtrimorese, të cilët kishin krye Normalen e Austrisë, pra, e kishin pa vetë zbatimin e tyre. Mësuesit që duelën nga Normalja që nga viti 1924 deri më 1934 i përhapën këto metoda më të katër anët e Shqipnisë, pse me të katër anët kishin normalistë.

Nga këta mësues filluen t'imitojnë edhe mësues të tjerë jo normalistë e kjo nuk bahej me vështirësi, pse edhe numuri i mësuesve atëhere ishte shumë i pakët, mbasi paditunia e injoranca e popullit ishin parime të regjimit antipopullor të Ahmet Zogollit.

Metodat herbartiane që nga normalja e Elbasanit u përhapën në të gjithë Shqipninë për këto arsye: 1) landët pedagogjike teorike të Normales përshkoheshin nga fryma herbartiane; 2) ato që mësoheshin në teori shkoheshin të zbatueme në praktikë n'ushtrimore; 3) me që mësuesit në përgjithësi deri atëhere ecnin nëpër tym, e ndiejshin nevojën e një metode të përcaktueme mirë, cilado t'ishte kjo; 4) metodat herbartiane ishin të studjueme hollësisht dhe në bazë të disa modeleve stereotipe mësuesi e kishte lehtë të ecte vazhdimisht nëpër disa rrugë të caktueme, siç ishin shkallët formale (paragatitja, paraqitja, thellimi, përdorimi e ushtrimi), metoda fonetike e shkrim-këndimit, mënyra e zhvillimit të mësimit të jetës, etj.; 5) autoriteti i mësuesve normalistë, të cilët në fillim qenë si një masë udhëheqëse e mësuesve në përgjithësi e ma vonë formuen edhe një pjesë të mirë të mësuesve të Shqipnisë; 6) në përhapjen e metodave herbartiane luejti rol edhe revista pedagogjike «Normalisti», organ i nxanësve të Normales, që botonte vazhdimisht prova mësimi, të cilat merreshin si model jo në mënyrë kritike prej shumicës së mësuesve; 7) metodat herbartiane hynë si metoda të reja, pse nuk njiheshin metoda të tjera ose ma të përparueme.

Sadoqë metodat herbartiane patën një vleftë për vendin tonë, pse e futën nëpër një farë rruge sistematike shko-

llën shqiptare, këto kishin edhe shumë të meta: shtypnin iniciativën e krijimtarinë e fëmijëve, nuk edukonin një të menduem kritik, ishin dogmatikë dhe mësuesin e çonin shpejt në formalizëm e në rutinë.

Këto të meta filluen të mos i kënaqnin në punën e tyre disa mësues t'afte e me eksperiencë, që kishin dalë po nga Normalja e Elbasanit. Kështu, tue çfrytëzue atë pak frengjishte që kishin mësue në Normale e që kishin vazhdue vetë si edhe disa gjuhë të hueja të tjera, disa mësues të qytetit t'Elbasanit, pjesa më e madhe normalistë, prunë libra në gjuhën frëngjishte, italishte, greqishte, turqishte dhe filluen të përkthenin e të përshtatnin disa ecuni pune të marruna nga këto libra, sidomos në arithmetikë, në dituni natyre, gjeografi, në mësim shtetnor (që bahej atëhere), etj. Gjithashtu disa mësues filluen të merrnin disa revista pedagogjike frënge si «L'edvkatër proletarjen», «L'ekol e la vi», «L'ekol liberatris», etj. Të gjitha këto qenë fillimet e krizës së metodave herbartiane në vendin tonë, që parajmëronin se një kthesë ishte e nevojëshme.

Kur nga ushtrimorja e Elbasanit u transferuen mësuesit normalistë t'Austrisë dhe vendin e tyre e zunë disa mësues të dalë nga Normalja e Elbasanit, mësues t'afte e me eksperiencë, por që ishin influencue nga metodat frënge e kjo tue fillue që nga viti 1934-35 e ma tepër nga viti 1936, atëhere në shkollën ushtrimore filluen të zbatoheshin disa metoda të tjera, të cilat ma tepër në formë eksperimentale. Kështu, për shembull në këndimshkrim u eksperimentue metoda globale, ajo e fjalëve normale dhe për këto filloi të shkruhej edhe nëpër revista, si në revistën «Normalisti»¹⁾ Filluen të çfaqeshin mendime të ndry-

shme mbi ecuni të ndjekuna në mësimin e këndimit²⁾, mbi përdorimin e abetares në kl. I-rë³⁾, etj.

Në këtë kohë, pra, filluen të rriheshin mendime, të çfaqeshin dyshime për këtë ose atë metodë, të babeshin eksperimente rreth metodave mësimore e të punës shkollore në përgjithësi, gja që solli si rrjedhim që monopoli i metodave herbartiane të lëkundej. Kjo frymë deri-diku liberalizmi filloi të përhapej edhe në çashtje të tjera shkollore, si në çashtjen e leximeve jashtë klasës të fëmijëve, në nevojën e letërsisë fëmimore e si duhet të jetë kjo, etj. Kështu, për shembull, normalisti revolucionar Qamil Guranjaku, me pseudonimin «Qukapiku» shkruente një artikull në revistën «Normalisti» në mënyrë sarkastike «... Dikush përketben aventurat e Arsen Lupenit, një tjetër Pickerton-in. E vërteta asht se duam të fitojmë lekë, se për kulturë nuk na ba malli fort. Le të rrojë edhe zyra e shtypit, mbasi nuk na e ve veshin se shka marrim e përkthejmë.

Kështu rafti i librave tona sot po qelbet fund e maje. Me përjashtim të disa librave, u ba për t'i vu xixën këtij rafti fund e krye...

Dibet se qëllimi i parë i çdo përkthimi asht dobija edukative (më falni se barrova) leku asht kryet e punës, të paktën ndër ne»⁴⁾.

Që nga 1935-a e ma tepër nga 1936-a n'ushtrimoren e Normales s'Elbasanit pjesërisht zbatoheshin disa metoda e ecuni herbartiane si në mësimin e jetës, etj. e pjesërisht metoda të tjera, të marruna andej-kënde; pra, nuk kishte një vijë të njëjtë e të përcaktueme mirë në çështjet metodike. Nga ana tjetër mësues të ndryshëm nga vende të ndryshme (Vlorë, Gjirokastër, Shkodër, Tiranë, Fier, etj.) filluen të zbatonin metoda a ecuni metodike të

1) Revista «Normalisti» Mars 1936, prill 1936

2) Po aty — mars 1936, maj 1936, dhjetor 1936

3) Po aty — shkurt 1936

4) Po aty — janar 1936

ndryshme, secili simbas gjuhës së huaj që dinte, nga e cila merrte lëndë.

Në vitin 1938, kur n'ushtrimoren e Normales s'Elbasanit pjesërisht mësonin disa mësues që kishin mbarue Institutin «Zhan-Zhak Ruso» të Gjenevës e atë të Lionit, metodat herbariane u tronditën edhe ma tepër në këtë shkollë, tue u luftue baza e tyne teorike e tue u zavëndësue me të tjera, të influencueme nga «L'ekol aktive» e Ferrietit, nga «Edukata funksionale» e Klaparedit, nga «Shtypshkronja në shkollë» e Freinit (Teknikë dhe Freinë) etj. Gjithashtu në këtë kohë u provue edhe shkrimi skript nga mësuesit e ushtrimore s'Elbasanit, si edhe nga disa mësues të rrallë në Tiranë, etj.

Asht për t'u shënue se gjatë okupacionit t'Italisë fashiste, sado që për një kohë drejtori i Normales ka qenë italian, në ushtrimore nuk ka pasë ndonjë influencë të metodave italiane. Fryma e reformës «Xhentile», që n'Itali u përhap me aq bujë, në Shqipëri s'u përfaque aspak, aq ma pak edhe n'ushtrimore, megjithëqë fashistët disa mësues të saj i transferuan, një drejtor e pushuen, etj.

Mbas fitores së revolucionit popullor edhe shkolla jonë hyni në rrugën e drejtë, në rrugën e shkollës sovjetike, të shkollës ma të përparueme në botë. Mbas çlirimit Normalja e Elbasanit, që ma vonë u quejt «Pedagogjika 10 Korrik», filloi të përhapë pedagogjinë sovjetike dhe metodat sovjetike, si me anë të pedagogjisë teorike e të psikologjisë, ashtu edhe me anë të metodikave të veçanta (në fillim këto i jepte mësuesi i landës teorike) e po ashtu me anë të punës të mësues

esve t'ushtrimore. të metodave që zbatohen atje e të praktikës që zhvillojnë kandidatët në klasat e ushtrimore.


Kur u fut për të parën herë në shkollat tona metoda analitike sintetike e shkrim-këndimit, mësuesit e ushtrimore e zbatuen atë me kujdes e rezultate të mira, tue u dhanë një model të mirë kandidatëve të pedagogjikës, të cilët si mësues jo i përhapnin metodat e shkollës sovjetike kudo në shkollat e vendit tonë, ku ata japin mësim.

Shkolla Pedagogjike «10 korrik» sot ka metoda të përcaktueme mirë, të bazueme në pedagogjinë sovjetike dhe n'eksperiencën e shkollës sovjetike e të shkollës sonë; këto metoda ajo i zbaton mirë, me përpikmëri dhe po kështu i zbatojnë edhe mësuesit që dalin prej saj, tue rrujtë traditat e mira të Normales së maparëshme.

Me futjen e pedagogjisë sovjetike në shkollat tona, përveç metodave të përdoruna në punën mësimore në klasë, për të parën herë si në gjithë vendin tonë ashtu edhe në ushtrimoren e Normales s'Elbasanit u vendos organizimi i fëmijëve në organizatën e pionierit. Kjo organizatë sot luan një rol me rëndësi për edukimin komunist të fëmijëve tanë. Edhe në këtë drejtim Pedagogjika «10 Korrik» me anën e ushtrimore përhap eksperiencën sovjetike dhe shërben si model për mësuesit e rij, që dalin prej saj e përhapen në të gjithë vendin.

S. PAPARISTO A. KAJANAKU

Mësues në Shkollën Pedagogjike
«10 Korrik» — Elbasan



Klasa e I e Ushtrimores më 1957-58



Personeli mësimor më 1958-59

Puna e Ushtrimorees sonë për përgatitjen e mësuesve të rinj

Në 50-vjetorin e themelimit të Shkollës Normale (pedagogjike), kujtojmë edhe punën e Ushtrimorees, si edhe rolin e saj për përgatitjen e mësuesve të rinj.

Shkolla ushtrimore ka qenë hapë, për nevojë të praktikës pedagogjike, në vitin 1923-24. Ka pasë vetëm klasën e parë fillore, ku dhanë mësim 15 kandidatë.

Më 1924-25 ushtrimorja u ba me dy klasë, por në të nuk u dhanë prova praktike; u banë vetëm hospitime, pse Normalja nuk nxuerr mësues, mbasi u shtue klasa e III.

Më 1925-26 ushtrimorja u ba me tri klasë dhe më 1929-30 me katër; me 1930-31 ajo bahet me pesë klasë. Çdo klasë kishte 24 nxanës, të cilët zgjidheshin e merreshin nga familje, që njiheshin për interesimin ndaj fëmijëve të tyre.

Në vitin shkollor 1938-39 shkollës ushtrimore i shtohet edhe një klasë kolektive (II e III) për vëzhgime e prova praktike dhe për përgatitjen e mësuesve të fshatit. Kjo vijoi deri më 1942-43, por nuk pati ndonjë përfundim të dukëshëm.

Okupacioni fashist, si në të gjitha shkollat e mësuesit e vendit tonë, ashtu edhe këtu pati jehonën e vet; ai e ngriti për rezistencë pasive e mandej për pjesëmarrje direkte personelin mësimuer e nxanësit kundër pushtuesit t'Atdheut.

Më 1941-42, mbas themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare, filloi lëvizja edhe midis personelit mësimuer të kësaj shkolle. Një pjesë e mësuesve, me Qamil Guranjakun në krye, u hodh në luftë.

Lëvizja në shkollë u ndihmue edhe nga kandidatët e nxanësit sidomos, ata të klasës së IV e V ushtrimore, që përdoreshin për të shpërndamë trakte

e material propagandistik. Sulë Misiri, Jorgji Dilo, Bardhyl Popa, Vasil Taja, etj; kanë qenë nxanës t'ushtrimorees dhe, kur u rriten, dhanë jetën në luftë për çlirimin e vendit.

Shkolla ushtrimore, qysh më 1923 e deri më 1934 ka pasë për mësues asish, që kishin kryem shkollën Normale t'Austrisë, të cilët futën në mësim metodat që kishin mësue në shtetin ku kryen studimet. Kuptohet, pra, se edhe parimet pedagogjike, që zbatoheshin atëhere n'ushtrimore, ishin ato të Herbartit, i cili njihet si pedagog dogmatik.

Në klasën e I shkërim-këndimi mësohesh me metodën fonetike dhe në çdo lëndë zinin vend me rëndësi shkallët formale të Herbartit e Zillerit. Por, nga njena anë, metodat e asaj kohe kanë qenë përparimtare dhe mbështeteshin në parime didaktike, sado të papërshtatëshme nga ana e psikologjisë. Por-e përsërisim - për atë kohë kanë qenë përparimtare, mbasi hodhën poshtë sistemin mësimor mesjetar, që përdornin mësuesit tanë.

Normalistët, që dolën nga Shkolla Normale ndërmjet viteve 1924-1934, u pritën me kënaqësi në popull si «normalistë t'Elbasanit». Kudo që shkuen ata futën në përdorim metodat e ushtrimorees, të cilat përmbysën e zvendësuan — në çdo lëndë — sistemin e vjetër në shkollë, si në mësim ashtu edhe në regjim e disiplinë. Ma vonë, nga viti 1934-1938, kur mësuesit e ushtrimorees u graduen njani mbas tjetrit inspektorë arësimi dhe vendin e tyre e zunë normalistët e Elbasanit, të daluëm e me eksperiencë didaktike, hyjnë këtu metoda të tjera të perëndimit, sidomos ato francezet.

Kur n'ushtrimore u emnuen asish që kishin kryem institutin «Zh. Zh. Ruso» në Zvicër, filloi të praktikohet

metoda «globale» e shkrim-këndimit në klasën e I dhe ajo e «fjalëve normale», në vend t'asaj fonetike. Këto u dhanë shkas kundërshtimeve e pasigurisë metodike ndërmjet mësuesve, pse secili kërkonte të mbizotonte metoda e tij, jo vetëm në klasën e I, por edhe në landët e klasave të tjera, si në këndim, arithmetikë, histori, gjeografi, mësim natyre e shkathësi të ndryshme.

Me gjithë që nuk kishte ndonjë program të caktuem, praktikës pedagogjike iu dha randësi e madhe nga Normalja dhe ushtrimorja e atëherëshme, por në pikëpamje formale.

Me gjithë këtë, në mbrendi, praktika pedagogjike dhe puna n'ushtrimore kishin mjaft dobësi: kandidatëve nuk u jepesh asnjë udhëzim metodik e landor, por vetëm tema; atyne u duhesh të përpëliteshin që t'ja përshtatin mësimin asaj metode, që kishin vëzhgue në hospitim në këtë ose atë klasë t'ushtrimores dhe nga ky ose ai mësues.

Ndërsa sot ngjan e kundërta: kandidatët i kanë të gjithë mundësitë me shkue përpara, mbasi veç teorisë së gjanë pedagogjike e metodike, ata kanë ndihmën e madhe të personelit mësimit t'ushtrimores, i cili u jep planin e udhëzimet me gojë (këto pakësohen me kohë) në një ditë të caktueme të javës dhe ma vonë ua koregjon konspektin dy-tri ditë përpara se, të paraqiten me dhanë provën praktike. Kandidatët konsultohen vazhdimisht edhe me udhëheqësin e praktikës dhe metodistët e landëve të ndryshme.

Nga ana tjetër, sot metodat dhe parimet didaktike janë të përbashkëta; ato jo vetëm s'krijojnë dyshime nga njeri mësues te tjetri, por ua bajnë të lehtë edhe kandidatëve rrugën që ndjekin në zhvillimin e mësimi. Sot në klasat e shkollës ushtrimore zbatohen metodat e aprovueme nga Ministria e Arësimit dhe Kulturës, të cilat nuk japin shkas për dyshime e interpretime të kota; dhe mësuesit e ushtrimores kanë uniformitet n'ecuninë e

çdo lande mësimore dhe në kërkesa të tjera.

Veç kësaj edhe analiza e vëzhgimit të mësimi shembëllor dhe e provës praktike ndryshonte nga ajo e sotmja. Mësuesi i ushtrimores ishte zot i klasës dhe autokritika e kritika s'bahe-shin fare, përveç një përkrahimi të mësimi të zhvilluem. Kurse n'ushtrimoren sot analiza bahet nën frymën e autokritikës e kritikës pedagogjike e metodike.

Vëzhgimet ose hospitimet, që zhvilloheshin atëhere, ishin shumë të pakët e të numuruem. Por edhe provat praktike ishin të rralla. Çdo kandidati nuk i takonte me dhanë ma tepër se 2-3 orë mësim gjatë ciklit në landë të paplanifikueme, por si t'u vinte mësuesve t'ushtrimores.

Kurse sot vëzhgimet fillojnë në klasën e II pedagogjike në lidhje me psikologjinë e në disa kapituj të pedagogjisë dhe vijojnë gjysëm viti në klasën e III. Ndërsa provat praktike zgjasin një vit të tanë, në gjysmën e dytë të klasës së III dhe në gjysmën e parë të klasës së IV; këto kapin së bashku 9 orë, veç një pune jashtë klase. Përveç këtyne çdo kandidat jep edhe praktikën një ditore, të vijueshme, dyjavore, dhe praktikën me klasa kolektive në fshat prej një jave.

Praktika që zhvillohet n'ushtrimore asht e lidhun ngushtë me zhvillimin e teorisë, që mësohet në pedagogjike, siç janë parimet didaktike, metodat në pedagogji, metoda analitike-sintetike e shkrim-këndimit, metoda e analizës n'arithmetikë, metoda induktive në gramatikë, puna jashtë klase, etj.

Shkolla jonë ushtrimore, qysh mbas çlirimit e kendej, nën shembullin e shkollës sovjetike, i ka qëndrue besnike parimet pedagogjik dhe kërkesave të jetës sonë të re, tue e lidhë sa ma ngushtë teorinë me praktikën, si në zhvillimin e programit për nxanësit e vet, ashtu edhe në punën e kandidatëve, tue tregue atyne rrugën metodiko-mësimore, që do të ndjekin në jetë si mësues dhe edukatorë.

MUSA TAFÀ

Lista e dëshmorëve të Shkollës Normale

Gjatë ekzistencës së saj 50-vjeçare, Shkolla Normale e Elbasanit i ka dhënë Atdheut disa nga bijt e saj më të mirë. Në krye të listës qëndron patrioti i çuar Avni Rustemi dhe pastaj vijjnë me radhë, sipas alfabetit, emërat e dëshmorëve të rënë gjatë luftës nacional-çlirimtare:

1. AVNI RUSTEMI
2. ANDON PROFKA
3. ABDYL MYZYRI
4. AGIM ÇOMO
5. ABDULLA HOXHA
6. BESIM IMAMI
7. BEQIR DARDHA
8. DHIMITËR MINO
9. FERIDUN XHINDOLLI
10. FIQRI BALTEZA
11. FEHMI KOTHERJA
12. GJON PENDAVINJI
13. HYQMET DUSHA
14. HAMDË RROSENI
15. HILMI DRASHOVICA
16. HAMDË VRIONI
17. IBRAHIM HASMENA
18. ILIA LARO
19. JORDAN MISJA
20. JORGJI DILO
21. JANI TODI
22. KOÇO ÇAMÇE
23. KADRI ABDIHOXHA
24. MEHMET KARADAKU
25. MEHMET PEPI
26. MUHARREM ÇOLLAKU
27. NDREC NDUE GJOKA
28. NDRIÇIM SHEHU
29. NAKIP SINOIMERI
30. NAIM GURI
31. RAMIZ TRENI
32. RAQI GRABOCKA
33. SULË MISIRI
34. SPIRO VELKO
35. SEIT LUZATI
36. SKËNDER LIBHOVA
37. SULEJMAN PAPRI
38. SYRJA DYLGJERI
39. SHEFQET LEKA
40. SPIRO GJINI
41. TOMA KALEFI
42. TAJAR MITARJA
43. TOMORR SINANI
44. XHAFERR FEJZO
45. XHEVDET HOXHA

Drejtori i parë i Shkollës Normale, patrioti Luigj Gurakuqi u vra pabesisht nga agjentë të Zogut në Itali në vitin 1925



AVNI RUSTEMI



Një koncert i normalistëve më 1937



Pjesa «Triumfi i Irlisë» — Çfaqur nga normalistët më 1943



Nga jeta e luftës nacional-çlirimtare, Normalja e Elbasanit dha 45 dëshmorë



Nxënësit e Shkollës Pedagogjike cfaqën më 1956 pjesën teatrale «Ne jemi qytetarë sovjetikë».

© 2000 - 2001